


EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 5989
E enje, 30 janar 2020
çmimi 0.40 €

Konjufca në Bruksel:
Zhgënjiye për qytetarët
e Kosovës ndjenja e të
qenit i izoluar | FAQE 3



FLET PËR "EPOKËN E RE", SHKËLZEN MALIQI | FAQE 4-5



KOKËFORTËSIA E LV-SË DHE LDK-SË, E PAKUPTIMTË

Analisti politik Shkëlzen Malqi ka vlerësuar se dallimet e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për arritjen e marrëveshjes janë aq të vogla saqë kokëfortësia e tyre bëhet e pakuptimtë. Në këtë intervistë dhënë për

gazeten "Epoka e re", ai ka deklaruar se qëndrimet e tyre të ngurta për kompromise lexohen vetëm si lakmi për pushtet. Malqi ka thënë se tërheqja nga pozicionet aktuale nuk do të thotë humbje për asnjëren parti. Sipas tij, nëse

koalicioni LV-LDK dështon, presidenti i vendit e ka rolin kyç për gjetjen e rrugëdaljes. Malqi thotë se presidenti duhet të konsultohet për një mandatar të dytë që, sipas tij, nuk duket zgjidhje shumë e mundshme ose të përsëriten zgjedhjet

NJË POLIC
KA NDËRRUAR
JETË DHE
DY TË TJERË
JANË
PLAGOSUR
GJATË NJË
OPERACIONI
ANTIDROGË
NË ZHUR TË
PRIZRENIT



I jepet lamtumira e fundit policit Sami Thaqi

Me nderime të larta poliore është varrosur të mëkurën policji Sami Thaqi, i cili ka rënë në krye të detyrës gjatë një operacioni antidrogë në Zhur të Prizrenit. Në ceremoninë e varrimit kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale. Për rënien në krye të detyrës, presidenti i

Kosovës, Hashim Thaçi, e ka dekoruar me urdhrin "Hero i Kosovës" policin Sami Thaqi, ndërsa Qeveria e Kosovës ka ndarë 15 mijë euro për familjen e tij. Po në shenjë nderimi për rënien e policit nga Malisheva, presidenti Thaçi ka vendosur që dita e sotme të jetë ditë zie në Kosovë | FAQE 6

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
 [facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)



OPINION

ORBITAT E RROTULLIMIT
TË TRUPAVE QIELLORE | F. 11

Shkruan: Naim
KRASNIQI, fizikan



AKTUALE



LUMEZI KËRKON PËRGJEGJËSI
DHE EFIKASITET MË TË MADH
NGA KRYEPROKURORËT
E PROKURORIVE | F. 5

RRETH 403 QYTETARË TË
KOSOVËS U BASHKUAN ME
GRUPE TË NDRYSHME
LUFTARAKE NË SIRI DHE IRAK | F. 7

EKONOMI

FAMILJET E POLICËVE TË
RËNË NË DETYRË DO TË MARRIN
PENSION NGA 300 EURO
NË MUAJ | F. 9

OEAK-U: ARBITRAZHI,
METODË E SHPEJTË DHE
EFIKASE QË GARANTON
ZGJIDHJEN E KONTESTEVE | F. 8

KULTURË

V. KONTRIBUTET NË FUSHË TË
HISTORISË SË LETËRSISË | F. 11

Prof. asoc. dr. Myrvete Dreshaj-BALIU
Prof. dr. Begzad BALIU

RENOVA
PUTZ
Makedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curë-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

WE

Thirrje për shprehje të interesit nga institucionet dhe organizata të ndryshme në sektorin e energjisë në Kosovë, për angazhim të praktikanteve në punë, paguar nga MFK.

Women in Energy

Gratë në Energji
Programi i Punës Praktike

Për të gjitha detajet:
[millenniumkosovo.org/
womeninenergy](http://millenniumkosovo.org/womeninenergy)

Në kuadër të projektit "Gratë në Energji - Women in Energy", të lansuar nga Fondacioni i Mijëvjeçarit i Kosovës (MFK), së shpejti do të fillojë zbatimi i programit "**Punë praktike për gra në sektorin e energjisë**" i cili ka për synim fuqizimin dhe përfshirjen e gruas në sektorin e energjisë në Kosovë.

Qëllimi i këtij programi është të mbështesë ngritjen e kapaciteteve të nevojshme profesionale të grave duke ju ofruar atyre përvojë përmes punës praktike me pagesë në institucionet publike dhe private të sektorit të energjisë në Kosovë. Paga bazike do të ofrohet nga MFK për kohë të caktuar deri në gjashtë muaj.

Përfituese të këtij programi do të janë të gjitha gratë dhe vajzat që shprehin interesim për praktikë në punë në sektorin e energjisë e të cilat janë në vitin e fundit të studimeve Bachelor, studentet e nivelit Master, si dhe ato që kanë diplomuar në tri vitet e fundit por që nuk kanë pasur mundësi të punojnë në profesionet e tyre. Profili i vajzave aplikante do të përfshijë jo vetëm ato që i përkasin fushave STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë), por edhe disiplina të tjera të rëndësishme për sektorin e energjisë, të tilla si menaxhimi i projektit, marketingu dhe financat, ekonomia, legjislacioni, politikë-bërje, teknologjia e informacionit si dhe profile të tjera të nevojshme në këtë sektor.

Andaj, ju bëjmë thirrje të gjitha **institucioneve në sektorin publik dhe privat, organizatave joqeveritare si dhe organizatave ndërkombëtare** të angazhuara në sektorin e energjisë në Kosovë, që kanë nevojë për kontributin e profesionisteve të reja si dhe shprehin interesim për të bashkëpunuar në këtë program të aplikojnë në web faqen tonë:

millenniumkosovo.org/womeninenergy



**MILLENNIUM
FOUNDATION
KOSOVO**



MILLENNIUM
CHALLENGE CORPORATION
UNITED STATES OF AMERICA

Gratë në Energji / Programi i Punës Praktike

Stoltenbergu: NATO-ja po punon në hapjen e hapësirës së ulët ajrore të Kosovës

BRUSEL, 29 JANAR - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg konfirmoi se aleanca ushtarake po punon për hapjen e hapësirës së ulët ajrore mbi Kosovë.

"Ekziston një proces, i cili lehtësohet nga NATO-ja dhe e adreson këtë çështje. Shpresoj se do të gjemë mënyra për t'u pajtuar për rihapjen e hapësirës së ulët ajrore dhe në këtë mënyrë të mundësojmë trafikun e drejtpërdrejtë ajror midis Beogradit dhe Prishtinës", tha Stoltenbergu të mëkurën në Brussel, ka njoftuar rfe.

Kosova dhe Serbia, në fillim të javës së kaluar kanë nënshkruar letrat e synimit, me të cilat parashihet vendosa e një linje të drejtpërdrejtë ajrore midis Prishtinës dhe Beogradit. Kjo linjë do të operohej nga kompania ajrore gjermane, Lufthansa. Marrëveshja është mirëpritur menjëherë nga aleanca e NATO-s. Linja e drejtpërdrejtë ajrore midis Prishtinës dhe Beogradit është ndërpërre më 1999 pas hyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë.

Në përputhje me rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, me Marrëveshjen Ushtarake-Teknike të vitit 1999 dhe me ligjet aktuale të Kosovës, për sigurinë e hapësirës ajrore të Kosovës përgjegjëse është NATO-ja, përkatësisht komandanti i misionit të KFOR-it. Pajtimi i NATO-s, është i domosdoshëm për rihapjen trafikut ajror midis Prishtinës dhe Beogradit, dhe Stoltenbergu konfirmoi se po punohet shumë për ta arritur këtë pëlgim brenda NATO-s.



Spanja paralajmëron bojkotin e Samitit të Zagrebit për shkak të Kosovës

Sipas burimeve, zyrtarët spanjollë i kanë paralajmëruar nikoqirët e samitit të ardhshëm se nuk do të marrin pjesë në takimin ku Kosova ka pjesëmarrje të barabartë me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe për këtë tashmë janë njoftuar diplomatët e vendeve tjera të BE-së

BRUSEL, 29 JANAR- Spanja kërçenon se do të bojkotojë Samitin e Zagrebit për shkak të pjesëmarrjes së Kosovës, merr vesh "Radio Evropa e Lirë" nga burime të besueshme në Madrid, Zagreb dhe Brussel.

Sipas tyre, zyrtarët spanjollë i kanë paralajmëruar nikoqirët e samitit të ardhshëm se nuk do të marrin pjesë në takimin ku

Kosova ka pjesëmarrje të barabartë me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Po sipas burimeve, diplomatët e vendeve tjera të Bashkimit Evropian janë njoftuar tashmë se Spanja mund ta anashkalojë Samitin e Zagrebit. Ky Samit midis përfaqësuesve të BE-së dhe atyre të Ballkanit Perëndimor do të mbahet më 6-



Susanna Vera (Reuters)

Borell vjen në Kosovë, takohet me presidentin Thaçi

PRISHTINË, 29 JANAR - Shefi për politikë të jashtme i Bashkimit Evropian (BE), Josep Borrell, sot (e enjte) do të qëndrojë për vizitë zyrtare në Kosovë.

Sipas agjendës së publikuar në faqen zyrtare të BE-së, ai në orën 14:00 do të takohet me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi.

Pas takimit, Borrelli dhe Thaçi

do të mbajnë një konferencë të përbashkët me gazetarë. Borrelli në Prishtinë do të takohet edhe me përfaqësuesit e partive politike si dhe ata të shoqërisë civile. Josep Borrell gjatë kësaj vizite do të lansojë një projekt të financuar nga BE-ja për të përmirësuar cilësinë e ajrit në Kosovë si dhe do ta vizitojë Prizrenin.

7 maj. Spanja nuk e njeh pavarësinë e Kosovës. Qeveria në Madrid e ka sfiduar pjesëmarrjen e barabartë të Kosovës në të gjitha tubimet e nivelit evropian. Ajo edhe më parë ka bojkotuar takime të ngjashme. Në vitin 2018 në Sofje, kur është mbajtur Samiti me Ballkanin Perëndimor, i pari pas 15 vjetësh, Madridi zyrtar nuk ka marrë pjesë për të njëjtat arsy. Në një takim joformal të ministritëve të jashtëm të BE-së dhe rajonit, i cili është mbajtur në Helsinki gushtin e kaluar, ministri i atëhershëm i Punëve të Jashtme të Spanjës, Josep

Borrell, është larguar nga sala për shkak të pranisë së ministrit të Kosovës. Atëbotë ai nuk ka qenë i emëruar për pozitën e shefit të Politikës së Jashtme të BE-së. I pyetur nga Shërbimi i Ballkanit i "Radios Evropa e Lirë", për problemet e mundshme në organizimin e samitit për shkak të pjesëmarrjes së barabartë të Kosovës, kryetari i Parlamentit kroat, Gordan Jandrokoviq, ka thënë se nuk është e lehtë të përpunohen interesat e të gjitha vendeve anëtare të BE-së. "Kur ka interesa të ndryshëm, atëherë negociohet gjatë", ka thënë Jandrokoviq, i cili ka konfirmuar se kryeministri kroat,

Andrej Plenkoviq, është në kontakt me të gjithë liderët evropianë rrëth organizimit të samitit. Jandrokoviqi, po ashtu, ka thënë se Qeveria e Kroacisë do të bëjë gjithçka të mundur për t'u dhënë vendeve të Ballkanit Perëndimor perspektivë të qartë evropiane. "Jo të gjitha vendet e BE-së kanë një qëndrim dhe entuziazëm të tillë. Ne do të flasim në interesin më të mirë të fqinjëve tanë", ka thënë mes tjerash ai. Sipas burimeve të "Radios Evropa e Lirë", zyrtarët në Zagreb janë të bindur se deri në maj do të gjendet një formulë që do t'i lejojë të gjithë të ftuarit në Samit të marrin pjesë.

Parlamenti Evropian miraton marrëveshjen për Brexit

STRASBURG, 29 JANAR - Parlamenti Evropian ka dhënë miratimin përfundimtar për largimin e Britanisë nga blloku evropian, duke hapur rrugën për Brexit nesër (e premte).

Në procesin e votimit, 621

ligjvëns kanë votuar në të mirë të largimit të Britanisë nga BE-ja për dallim nga 49 që kanë votuar kundër dhe 13 të tjerë kanë abstenuar. Përveç votimit është dëgjuar edhe një këngë tradicionale sko-

ceze për t'i dhënë lamtumirën e fundit Britanisë si anëtare e BE-së. Rezultatet e referendumit të vitit 2016 treguan se 52 për qind e britanikëve janë në favor të largimit nga BE-ja.

Pas 31 janarit, procesi i Brexit-it do të ketë një periudhë transicioni deri në fund të vitit. Kryeministri britanik, Boris Johnson ka mohuar se do të ketë shtyrje të kësaj periudhe transicioni.



Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka marrë pjesë në Samitin e Kryetarëve të Parlamenteve të Ballkanit Perëndimor në Bruksel

Konjufca në Bruksel: Zhgënjiye për qytetarët e Kosovës ndjenja e të qenit i izoluar

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, në fjalën e tij në Samitin e Kryetarëve të Parlamenteve të Ballkanit Perëndimor në Bruksel, ka folur për vendin tonë dhe sfidat që e përcjellin atë në rrugëtimin drejt integrimeve evropiane. Ai ka thënë se Kosova është duke u ballafaquar me sfida të shumta në rrugëtimin e saj evropian. "Kanë kaluar 96 muaj nga kur e kemi filluar dialogun për liberalizimin e vizave dhe sot ne mbësim vendi i vetëm që nuk është liruar nga regjimi i vizave në Zonën e Shengenit", ka thënë Konjufca, duke shtuar se është shumë zhgënjiye për qytetarët e Kosovës ndjenja e të qenit i izoluar



EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

BRUSEL, 29 JANAR - Parlamenti Evropian ka mbetur mbrojtësi i palëkundur i perspektivës evropiane për Ballkanin Perëndimor. Kështu ka thënë të mërkurën kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, në Samitin e Kryetarëve të Parlamenteve të Ballkanit Perëndimor, i cili është duke u mbajtur në Bruksel. Gjatë këtij samiti, i organizuar dhe kryesuar nga presidenti i Parlamentit Evropian, David Maria Sassoli, përpërsëisht kryeparlamentarit Konjufca, po marrin pjesë edhe kryetarët e parlamenteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor, shefat e grupeve politike të Parlamentit Evropian, si dhe reporterët e Parlamentit Evropian për Ballkanin Perëndimor.

Në punimet e këtij Samiti ndër çështjet kryesore që po diskutohen janë: bashkëpunimi parlamentar dhe e ardhmja e Evropës, me theks të veçantë procesi i zgjerimit të saj.

Duke iu drejtuar pjesëmarrëseve të këtij samiti, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, pasi ka falënderuar presidentin Sassoli për iniciativën e mbajtjes së këtij samiti dhe përkushtimin e tij ndaj perspektivës evropiane të Ballkanit Perëndimor, ka thënë se: "Ne në Ballkanin Perëndimor e dimë shumë mirë

rëndësinë e Projektit Evropian. Qysh prej përfundimit të luftërave të viteve '90 procesi i integrimeve evropiane e ka drejtuar shoqërinë tonë drejt demokracisë dhe zhvillimit ekonomik. Shoqëria jonë ka ndërtuar institucione të pavarura, media pluraliste dhe shoqëri civile aktive".

Konjufca para të pranishmëve ka nënizuar suksesin e procesit të zgjedhjeve në Kosovë dhe u shpreh se pas konstituimit të Kuvendit, Kosova së shpejti do ta ketë edhe qeverinë e re.

Duke folur për vendin tonë dhe sfidat që e përcjellin atë në rrugëtimin drejt integrimeve evropiane, kreu i Kuvendit, Konjufca, ka thënë se Kosova është duke u ballafaquar me sfida të shumta në rrugëtimin e saj evropian. "Pavarësisht nga arrija e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim ne nuk kemi shkuar drejt statusit të vendit kandidat. Kanë kaluar 96 muaj nga kur e kemi filluar dialogun për liberalizimin e vizave dhe sot ne mbësim vendi i vetëm që nuk është liruar nga regjimi i vizave në Zonën e Shengenit", ka thënë ai, duke shtuar se është shumë zhgënjiye për qytetarët e Kosovës ndjenja e të qenit i izoluar.

Konjufca ka folur edhe për dialogun me Serbinë, për të cilin ka thënë se e kuptojmë plotësisht rëndësinë e

marrëdhënieve të mira fjinjësore dhe mbetimi të përkushtuar ndaj dialogut me Serbinë që lehtësohet nga BE-ja. Lidhur me këtë, ai deklaroi se qeveria e re do të ndërmarrë hapa të rëndësishëm në këtë drejtim. Ai, po ashtu, foli edhe për pritet e qytetarëve nga qeveria e re.

Duke folur për zgjerimin e BE-së, përkatësisht integrimin e shteteve të Ballkanit Perëndimor, kreu i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë se inkurajojnë hapjen e negociatave sa më parë të bisedimeve për anëtarësimin e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut. "Ne besojmë se Samiti i Zagrebit për Ballkanin Perëndimor do të jetë shumë i rëndësishëm për këtë qëllim", është shprehur Konjufca.

Në fund të fjalës së tij, kryeparlamentari Konjufca ka falënderuar Parlamentin Evropian që ka mbetur mbrojtësi i palëkundur i perspektivës evropiane për Ballkanin Perëndimor. "Unë plotësisht e kuptoj që nuk jemi në një kohë të lehtë për Evropën për të besuar në fuqinë e Unionit të Zgjeruar, por besimi në gjërat e duhura në kohë të vështira është ajo që e dallon një përfaqësues shteti të guximshëm nga politikani oportunist", ka vlerësuar Konjufca në Samitin e Kryetarëve të Parlamenteve të Ballkanit Perëndimor.



Konjufca takohet me Franzin dhe Piculën

Në ditën e dytë të vizitës së tij në Bruksel, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka takuar udhëheqësin e Delegacionit për Marrëdhënie me Bosnie-Hercegovinën dhe Kosovën në Parlamentin Evropian, Romeo Franz, si dhe Udhëheqësin e Grupit Punues për Ballkanin Perëndimor në Komisionin për Politikë të Jashtme (AFET) në

Parlamentin Evropian, Tonino Picula. Gjatë takimit me Franz u diskutua në detaje lidhur me mundësitet e bashkëpunimit parlamentar ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit Evropian. Ndërkaq gjatë takimit të Konjufcës me Piculan u diskutua përgjendjen politike dhe të sigurisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Flet për "Epokën e re", Shkëlzen Maliqi

Kokëfortësia e LV-së dh

Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka vlerësuar se dallimet e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për arritjen e marrëveshjes janë aq të vogla saqë kokëfortësia e tyre bëhet e pakuptimtë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se qëndrimet e tyre të ngurta për kompromise lexohen vetëm si lakmi për pushtet. Maliqi ka thënë se tërheqja nga pozicionet aktuale nuk do të thotë humbje për asnjëren parti. Sipas tij, nëse koalicioni LV-LDK dështon, presidenti i vendit e ka rolin kyç për gjetjen e rrugëdaljes. Maliqi thotë se presidenti duhet të konsultohet për një mandatar të dytë që, sipas tij, nuk duket zgjidhje shumë e mundshme ose të përsëriten zgjedhjet

EPOKA
ERE

Muhamet KOÇI

PRISHTINË, 29 JANAR - Analisti politik Shkëlzen Maliqi ka bërë me dije se marrëveshjen për bashkëqeverisje në mes të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) po e pengojnë qëndrimet e ngurta të dy palëve. Ai ka vlerësuar se tërheqja nga pozicionet aktuale nuk do të thotë humbje për asnjëren parti.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Maliqi ka thënë se më e arsyeshme do të ishte që të bisedohej me këtë përkushtim për personat që do t'i marrin resorët dhe përgjegjësit dhe si do të realizohet programi për të cilin është thënë se u realizuan më lehtë se kjo çështja e posteve", ka thënë Maliqi. Megjithatë, ai nuk e ka përjashtuar mundësinë që koalicionin mes këtyre dy subjekteve politike po e pengon diçka tjetër. Sipas Maliqit, të dyja palët mund ta ndiejnë peshën e shtuar të përgjegjësisë para proceseve të vështira që e presin qeverinë e re.

"Marrëveshjen e pengon

qëndrimi i ngurtë i të dy palëve sepse nuk po kanë vullnet që të bisedojnë për nuancat që i ndajnë nga zgjidhja. Në këtë rast tërheqja nuk do të thotë assesi humbje. Më e arsyeshme do të ishte nëse do të bisedohej me këtë përkushtim për personat që do t'i marrin resorët dhe përgjegjësit dhe si do të realizohet programi për të cilin është thënë se u realizuan më lehtë se kjo çështja e posteve", ka thënë Maliqi. Megjithatë, ai nuk e ka përjashtuar mundësinë që koalicionin mes këtyre dy subjekteve politike po e pengon diçka tjetër. Sipas Maliqit, të dyja palët mund ta ndiejnë peshën e shtuar të përgjegjësisë para proceseve të vështira që e presin qeverinë e re. "Mbase

keni të drejtë kur supozoni se duhet të ketë edhe diçka tjetër që e motivon mosbesimin e ndërsjellë. Nuk dua të psikologjizoj, por të dyja palët, si duket e ndiejnë peshën e shtuar të përgjegjësisë para proceseve të vështira që e presin qeverinë e re, siç janë vazhdimi i dialogut dhe arritja e marrëveshjes obliguese me Serbinë në kushtet kur nuk dihet se çka mund të sjellë ajo, pastaj pasojat e Gjykatës Speciale, luftimi i korruptionit dhe vendosja e sundimit të ligjit si dhe një mori problemesh ekonomike dhe të tjera që janë neglizhuar tash e sa vite", është shprehur Maliqi. Ai ka vlerësuar se nëse dështon arritja e këtij koalicioni përgjegjësia do të jetë e të dy

partive. Sipas Maliqit, kokëfortësia e këtyre dy subjekteve politike është e pakuptimtë. "Nuk jam i sigurt se kujt do t'i mbetet kilja, siç thotë një shprehje popullore. Nga bisedat që kam me njerëzit, kam përshtypjen se shumica i fajeson të dyja palët, mbase përfaktin që përmenda më herët, se dallimet janë aq të vogla që kjo kokëfortësi bëhet e pakuptimtë, lexohet vetëm si lakmi për pushtet", është shprehur analisti Maliqi.

"Epoka e re": Z. Maliqi, pa ndonjë sukses ka përfunduar edhe takimi i së martës ndërmjet LV-së dhe LDK-së, në të cilin ishin të pranishëm edhe ambasadorët e vendeve të

Quintit. Çfarë po ndodhë me negociatat në mes të këtyre dy partive?

Maliqi: Është një bllokadë për arritjen e koalicionit sepse asnjëra prej palëve nuk zmbrapset nga qëndrimet e ngurta, edhe pse thonë se janë shumë afër marrëveshjes. Aktualisht, sa dimë, kontestuese është pozita e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, i cili post është i zënë, Kuvendi më 26 dhjetor e zgjodhi Glauk Konjufcën edhe me votat e deputetëve të LDK-së. Lëvizja Vetëvendosje konsideron se rrëth këtij posti nuk ka kthim prapa, se duhet t'i mbetet Glauk Konjufcës, kurse LDK-ja kërkon që ai të tërhiqet dhe t'i bëjë vend kandidatit të LDK-së. Nga ana

e LDK-së, e pakuptimtë

janë të mëdha, dhe besoj se do të mund të zgjidheshin ditëve në vijim. Edhe nëse janë konsideruar opsonet e tërheqjes dhe pajtimit, më duket se ato janë lënë përmoment të fundit, ndërkohë që për çdo rast, nëse dështron koalicioni, kërkojnë alibi në fajësimin e partnerit se tjetri nuk po lëshon pe. Mendoj se edhe ftesa për praninë e ambasadorëve ka pasur këtë qëllim, që ambasadorët të "binden" dhe bëhen dëshmitarë se kush është fajtor. Kjo po më duket një sjellje politikisht krejtësisht e papjekur.

"Epoka e re": Kush mendoni se po e pengon një marrëveshje LV-LDK?

Maliqi: Marrëveshjen e pengon qëndrimi i ngurtë i të dyja palëve sepse nuk po kanë vullnet që të bisedojnë përmundësia e një koalicioni të tjerë. Në këtë rast tërheqja nuk do të thotë assesi humbje. Më e arsyeshme do të ishte nëse do të bisedohej me këtë përkushtim përmendur që do të marrin resorët dhe përgjegjësitë dhe si do të realizohet programi përmendur që do të cilin është thëne se u realizuan më lehtë se kjo çështja e posteve. Por, ju mbapse keni të drejtë kur supozoni se duhet të ketë edhe diçka tjetër që e motivon mosbesimin e ndërsjellë. Nuk dua të psikologizoj, por të dyja palët si duket e ndiejnë peshën e shtuar të përgjegjësë para proceseve të vështira që e presin qeverinë e re, siç janë vazhdimi i dialogut dhe arritja e marrëveshjes obligeuse me Serbinë në kushtet kur nuk dihet se çka mund të sjellë ajo, pastaj pasojat e Gjykatës Speciale, luftimi i korruptionit dhe vendosja e sundimit të ligjit si dhe një mori problemesh ekonomike dhe të tjera që janë neglizhuar tash e sa vite.

"Epoka e re": Nëse dështron arritja e këtij koalicioni, e kujt do të ishte përgjegjësia?

Maliqi: Nuk jam i sigurt se kujt do t'i imbetet kilja, siç thotë një shprehje popullore. Nga bisedat që kam me njerëzit, kam përshtypjen se shumica i fajësorëve të dyja palët, mbapse përfaktin që përmenda më herët, se dallimet janë aq të vogla që kjo kokëfortësi bëhet e pakuptimtë, lexohet vetëm si lakmi përmes pushtetit.

tjetër, LV-ja ofron si kompensim një post shtesë ministror, kurse LDK-ja mendon se me këtë nuk sigurohet bilanci i duhur i ndarjes së pushtetit. As ambasadorët e Quintit, që kësaj here nuk kanë qenë kompleti në numër, nuk kanë sjellë ndryshim, edhe ashtu kanë qenë vetëm vëzhgues, nuk kanë ndikuar ose diriguar me vendimmarrjen.

"Epoka e re": Pas takimit palët fajësuan njëra-tjetren se nuk po lëshojnë pe. A ka ende shpresë se mund të ndodhë një koalicion i tillë?

Maliqi: Shikuar nga jashtë, sepse nuk e dimë se si është atmosfera brenda bisedimeve, dallimet në qëndrime vërtet nuk

ketë nevojë përmendur që i konsulton presidenti e ka rolin kyç në gjetjen e rrugëdaljes, të konsultohet përmendur që nuk më duket shumë e mundshme, ose të përsëriten zgjedhjet. Disa po e përmendin qeverinë e spektrit të gjere ose qeverinë teknike,

por edhe këto opsonë do të janë tema që i konsulton presidenti nëse ka disponim përmendur që këtë, dhe pastaj ta propozojë kandidatin i cili mund ta sigurojë shumicën, gjithsesi me kusht që qeveria e gjerë ose ajo teknike, të janë të afatizuara përmendur që nuk do të sjellin raport mes rezultateve të forcave.

përfaktin se nëse zgjedhjet do të mbaheshin në këtë pranverë, ekziston rreziku që të përsëritet blllokada si kjo që e kemi, pasi që zakonisht në afat e shkurtra disponimi i elektoratit edhe nuk ndryshon aq shumë, ose edhe ndryshimet nuk do të sjellin raport mes rezultateve të forcave.

Lumezi kërkon përgjegjësi dhe efikasitet më të madh nga kryeprokurorët e prokurorive

PRISHTINË, 29 JANAR (ER) - Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ka mbajtur të mërkurën kolegjumin e parë përvitin 2020 me të gjithë kryeprokurorët e prokurorive themelore në nivel vendi, kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale, kryeprokurorin e Prokurorisë së Apelit dhe Kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës. Në fillim të këtij takimi kryeprokurori Lumezi është njoftuar nga ana e kryeprokurorëve përmendur që do të raportit të punës përvitin 2019, me ç'rast ka vlerësuar në përgjithësi punën e bërë nga të gjitha prokurorët gjatë vitit 2019, me qëlamë pas.

Po gjatë prezantimit të planit të punës përvitin 2020, kryeprokurori i Shtetit ka kerkuar nga kryeprokurorët e të gjitha niveleve efikasitet më të madh në trajtimin e rasteve të korruptionit, krimeve ekonomike, në sekuestrimin

dhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme, si dhe luftimin e të gjitha veprave të tjera penale të cilat janë në kompetencë të këtyre prokurorive.

Njëra nga pikat e rendit të ditës ishte edhe përgjegjësia e kryeprokurorëve të gjithë të udhëheqjen e prokurorive përkatëse. Në këtë drejtim, kryeprokurori i Shtetit ka kerkuar angazhim dhe rol më aktiv nga kryeprokurorët në mbikëqyrjen dhe avancimin e punës së prokurorëve, ngritjen e transparencës, llogaridhënieve, forcimin e komunikimit me mediat dhe shoqërinë civile, si dhe thëllimin e bashkëpunimit me institucionet e tjera të zbatimit të ligjit.

Gjithashtu, kryeprokurori i Shtetit ka kerkuar nga kryeprokurorët të kenë koordinim më të madh lidhur me bartjen e lëndëve nga prokurorët themelore në Prokurorinë Speciale dhe

anasjelltas.

Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, kerkoi nga kryeprokurorët që t'i shojnë edhe iniciativat përmbrojtjen e ligjshmërisë, pasi kjo tregon vendosmërinë e prokurorëve në luftimin e veprave të ndryshme penale.

Gjatë këtij takimi u diskutua edhe përmirësimin e kushtave të punës në sistemin prokurorial, përritjen e numrit të prokurorëve nëpër prokurori, me theks të veçantë në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.

Lidhur me këtë, kryeprokurori i Shtetit ka kerkuar nga të gjithë kryeprokurorët që t'i identifikojnë prokurorët të cilët kanë treguar performance të mirë, guxim dhe integritet të lartë, në mënyrë që të avancohen në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, pasi kjo prokurori duhet të forcohet edhe më tutje me prokurorë të tjera dhe të ketë efikasitet më të madh në punën e saj.



"Epoka e re": Cilat janë alternativat pas dështimit të koalicionit LV-LDK, qeveri gjithëpërfshirëse apo zgjedhje të reja?

Maliqi: Mendoj se nuk do të

Një polic ka ndërruar jetë dhe dy të tjerë janë plagosur gjatë një operacioni antidrogë në Zhur të Prizrenit

I jepet lantumira e fundit pollicit Sami Thaqi

Me nderime të larta pollicore është varrosur të mëkurën polici Sami Thaqi, i cili ka rënë në krye të detyrës gjatë një operacioni antidrogë në Zhur të Prizrenit. Në ceremoninë e varrimit kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale. Për rënien në krye të detyrës, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, e ka dekoruar me urdhrin "Hero i Kosovës" pollicin Sami Thaqi, ndërsa Qeveria e Kosovës ka ndarë 15 mijë euro për familjen e tij. Po në shenjë nderimi për rënien e pollicit nga Malisheva, presidenti Thaçi ka vendosur që dita e sotme të jetë ditë zie në Kosovë

"Epoka e re"

PRISHTINË, 29 JANAR - Të mëkurën i është dhënë lanturia e fundit pollicit Sami Thaqi, i cili ka rënë të martën në krye të detyrës gjatë një operacioni policor antidrogë në Zhur të Prizrenit.

Ceremonia e varrimit është

Ata kanë kërkuar nga organet e rendit dhe të drejtësisë që ta zbardhin këtë rast. Po ashtu, ata u kanë uruar shërim të shpejtë policëve Artur Mrasori e Jetmir Hasani të cilët kanë mbetur të plagosur nga operacioni policor ku ka mbetur i vdekur polici Sami Thaqi. Në këtë operacion policor, i cili ka pasur për qëllim bastisjen e një



të tyre, Sami Thaqi, që me përgjegjësi të lartë, bashkë me dy kolegët e tjerë të lënduar rëndë, kanë qenë duke kryer misionin e tyre gjatë një aksioni antidrogë në Zhur të Prizrenit. "Është për keqardhje dhe shumë e rëndë që në krye të detyrës po humbin jetën pjesëtarë të policisë sonë, ata që janë mburoja e sigurisë së vendit. Përgjegjësit duhet ta marrin dënimin e merituar", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Më pas Haradinaj ka vizituar në spital edhe dy policët e plagosur, të cilëve u ka uruar shërim të shpejtë. Pas kësaj vizite Haradinaj ka mbajtur mbledhjen e qeverisë, ku ka ndarë 15 mijë euro për familjen e pollicit Sami Thaqi dhe nga 10 mijë euro për familjet e policëve të lënduar, Artur Mrasori dhe Jetmir Hasani. Për 20 vjet në Kosovë janë vrarë 21 police në krye të detyrës.

Polici i vrarë Sami Thaqi dekorohet me urdhrin "Hero i Kosovës"

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, e ka dekoruar me urdhrin "Hero i Kosovës" pollicin Sami Thaqi, i cili ka rënë të martën mbrëma në krye të detyrës. Thaqi është profilin e vet në "Facebook" ka shkruar se heroizmi i Samiut dhe policive të tjerë të rënë në krye të detyrës është krenari e Republikës së Kosovës. "Polici i rënë në krye të detyrës, Sami Thaqi, është hero më i ri i Republikës së Kosovës. Duke u bazuar në kompetencat e mia kushtetuese, sot për policin Sami Thaqi ndava urdhrin 'Hero i Kosovës'. Heroizmi i Samiut, Enverit, Izetit, dhe i dhjetëra policëve të rënë në krye të detyrës, është krenari e Republikës së Kosovës. Sakrifica e tyre në mbrojtje të rendit dhe ligjit na obligon që të punojmë edhe më shumë për një Kosovë të qetë e stabile dhe një vend më të mirë përgjithë qytetarët tanë", ka shkruar Thaqi.



Policia e Kosovës

IN MEMORIAM



Sami (Bajram) THAQI

(30.12.1982 - 28.01.2020)

zhvilluar në fshatin Shkarashnik të Komunës së Malishevës, ku kanë marrë pjesë qytetarë të shumtë, drejtuesit kryesorë të Policisë së Kosovës, të Ushtrisë së Kosovës, drejtues të pushtetit lokal dhe përfaqësues e drejtues të organeve të tjera shtetërore.

Në ceremoninë e varrimit për veprën e pollicit Sami Thaqi kanë folur drejtori i përgjithshëm i Policisë, Reshit Qalaj, kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe Metush Kryeziu nga OVLUÇK-ja, të cilët e kanë vlerësuar lart veprën e tij. Me rastin e rënies në krye të detyrës të pollicit Sami Thaqi, presidenti Hashim Thaçi, kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, lideri i LV-së, Albin Kurti, ai i LDK-së, Isa Mustafa, kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, ai i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, kanë ngushëlluar familjen Thaqi.



Sot ditë zie në Kosovë në nderim të pollicit Sami Thaqi

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, pas rënies në krye të detyrës të pjesëtarit të Policisë së Kosovës, Sami Thaqi, ka shpallur ditën e sotme ditë zie, në shenjë nderimi shtetëror për pollicin e rënë. Në pajtim me legjislacionin në fuqi, në ditën e zisë, të shpallur për ta nderuar jetën dhe veprën e pollicit Sami Thaqi, flamuri shtetëror ngrihet në gjysmështizë në të gjitha objektet shtetërore të Republikës së Kosovës, brenda dhe jashtë vendit



Rreth 403 qytetarë të Kosovës u bashkuan me grupe të ndryshme luftarake në Siri dhe Irak

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 JANAR - Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), me mbështetjen e Institutit Ndërkombëtar Republikan (IRI), ka publikuar të mërkurën raportin hulumtues në lidhje me qasjet e Qeverisë së Kosovës për ta mbështetur riintegrimin e të kthyerve nga zonat e luftës në Siri dhe Irak.

Gjetjet tregojnë se Kosova është ndër vendet e rralla që ka qenë e gatshme t'i riatdhesojë qytetarët e saj nga Siria dhe Iraku. Raporti tregon se ndërsa qeveria ka krijuar mekanizmat e nevojshëm institucionalë për ta koordinuar dhe menaxhuar riintegrimin e të kthyerve, ekziston një mungesë e politikës koherente dhe ka sfida të rëndësishme në lidhje me koordinimin si dhe përfshirjen e shoqërisë civile në proces.

Në hapje të konferencës me rastin e publikimit të raportit, Teuta Avdimetaj nga QKSS-ja ka thënë se vlerësohet se rreth 403 kosovarë u bashkuan me grupe të ndryshme luftarake në Siri dhe Irak.

Avdimetaj ka thënë e rënia e organizatës terroriste famëkeqe ISIS ka krijuar një situatë të re për shumë vende evropiane, përfshirë Kosovën, se çfarë të bëjnë me qytetarët e tyre që mbeten në Siri dhe Irak. Prandaj, sipas saj, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë me mbështetjen e Institutit Ndërkombëtar Republikan bëri hulumtime pikërisht në këtë temë.

Qëllimi kryesor i raportit që është publikuar sot është të analizojë se si qeveria dhe aktorët e tjerë janë përgjigjur në çështjen e riatdhesimit të kosovarëve nga zonat e luftës në Siri dhe Irak si dhe se si u mbështet riintegrimi i tyre në shoqëri.

Skënder Perteshi, hulumtues në QKSS, dhe njëri nga autorët e



raportit, ka pohuar se në lidhje me mbështetjen e riintegrimit të të kthyerve, gjetjet e raportit përfshijnë dy qasje të përgjithshme. Ka masa ndëshkuese-restauruese dhe mbështetje të riintegrimit shoqëror.

Shërbim Korrekta i Kosovës ka krijuar programe të veçanta për ta mbështetur rehabilitimin dhe deradikalizimin e atyre të kthyerve nga zonat e luftës në Siri dhe Irak që janë në burg. Këto përfshijnë kurse të zhvillimit të aftësive për t'i rritur shanset e tyre të punësimit pas lirimit, trajnime të tjera të ndryshme, si dhe ligjërata fetare nga imamët e siguruar nga Bashkësia Islame e Kosovës.

Mirëpo, sipas Perteshit, për sa i përket suksesit të përpjekjeve për

rehabilitim dhe deradikalizim në shërbimin korrekta, gjetjet e raportit nuk janë shumë pozitive. Sipas vetë zyrtarëve të Shërbimit Korrekta, ndërsa ka përparim, një pjesë e rëndësishme e të kthyerve mbeten besnikë ndaj të ashtuquajturës 'Shtet Islamik' dhe ideologjive ekstremiste. Në lidhje me mbështetjen e riintegrimit shoqëror qeveria ka krijuar një divizion të specializuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme për ta menaxhuar dhe koordinuar mbështetjen përiintegrim e të kthyerve nga zonat e luftës në Siri dhe Irak. Përderisa qasja e qeverisë ka qenë pozitive, Perteshi argumenton se ka mungesë të një politike koherente si dhe ka sfida me koordinim.

Rekomandimet e dala nga rapporti

- Qeveria të kryejë një shqyrtim gjithëpërfshirës të politikave dhe institucioneve që koordinojnë dhe zbatojnë aktivitete që synojnë mbështetjen e riintegrimit të të kthyerve nga zonat e luftës.

- Qeveria të miratojë një koncept-dokument se si të riorganizohet mekanizmi ekzistues institucional që merret me deradikalizimin dhe riintegrimin, si dhe të krijohet një politikë koherente qeveritare mbi riintegrimin social dhe ekonomik të të kthyerve.

- Ministria e Punëve të Brendshme duhet ta krijojë Grupin Këshillues të Shoqërisë Civile përiintegrimin në mënyrë që të përfshihen OJQ-të në përpjekjet e riintegrimit përmes partneritetit me institucionet qeveritare.

Mbahet trajnim për menaxhim në shëndetësi



PRISHTINË, 29 JANAR (ER) - Kompania Konsultante "ICME-Healthcare", e angazhuar përmes projektit shëndetësor në Kosovë, në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar, ka nisur këtë javë trajnimin në lidhje me menaxhimin spitalor për profesionistët shëndetësorë. Trajnim i mbahet me qëllim të transferimit të përvjovave dhe njohurive menaxheriale si bazë

e rëndësishme për përmirësimin e përgjithshëm të sistemit shëndetësor dhe rritjen e ofrimit të shërbimeve me cilësi më të lartë, në një kohë më të shkurtër. Në të po marrin pjesë drejtore të klinikave të QKUK-së, të spitaleve të përgjithshme, të shëndetit mendor dhe njësive të tjera të ShSKUK-së. Të pranishëm kanë qenë edhe drejtoret e infirmierës dhe të

administratës si dhe shefat e sektorëve teknikë-administrativë. Trajimi po zhvillohet në pesë module të veçanta, të cilat janë hartuar nga ekspertë të fushës së menaxhimit spitalor: menaximi për herë të parë, shkathtësitë e komunikimit, zgjidhja e problemit, mësimi dhe motivimi dhe menaxhimi i performancës.

Kosova dhe Shqipëria synojnë rritjen e bashkëpunimit ekonomik

PRISHTINË, 27 JANAR (ER) - Ministri në detyrë i Financave, Lulzim Rafuna, ka pritur në takim ndër-ambasadorin e Shqipërisë

në Prishtinë, Qemal Minxhozi. Qëllimi i takimit ishte diskutimi për shtimin e bashkëpunimit ndërshtetëror, në veçanti atij

ekonomik. Në këtë takim është biseduar edhe përvillimin e bizneseve si dhe për adresimin e sfidave në fushën e ekonomisë të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në fuqizimin e sektorit privat si bartës të rritjes ekonomike në të dyja vendet.



OEAK-u: Arbitrazhi, metodë e shpejtë dhe efikase që garanton zgjidhjen e kontesteve

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 29 JANAR - Arbitrazhi si metodë për zgjidhjen e kontesteve vazhdon të mbetet metodë më efikase dhe më e shpejtë në krahasim me gjykatën. Një gjë e këtillë është konkluduar të mëkurën në një tryezë të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, ku përfaqësuesit e bizneseve diskutuan me njohësit e arbitrazhit.

Ardi Shita, avokat dhe anëtar i Këshillit Drejtues të Qendrës së Arbitrazhit të Odës Ekonomike Amerikane, e cilësoi pozitiv faktin se sot ekzistojnë qendra funksionale të arbitrazhit si dhe përfshirje të klauzolave të

arbitrazhit në kontrata. Ai ka dekluaruar se njohja në procedurë të shpejtë të vendimeve të arbitrazhit nga gjykata lehtëson ekzekutimin e vendimit. Si përparsi të kësaj metode alternative, Shita përmendi shpejtësinë e procesit dhe lirinë e palës për ta dizajnuar procesin ashtu që i njëjti t'u përshtatet më së miri kërkesave të veta. Sipas tij, klauzola e arbitrazhit, e paraparë në kontratë, ndihmon palët të jenë më të disiplinuara, gjë kjo që është kritike në çështje ekonomike.

Kurse Njomëza Zejnnullahu, këshilltare e lartë ligjore në projektin e USAID-it për Drejtësinë Komerciale, ka thënë se USAID-i e sheh promovimin e

arbitrazhit si të rëndësishëm, pasi që i njëjti ka rol signifikant përvillimin ekonomik dhe tjerheqjen e investimeve të huaja direkte në vend. "Qëllimet kryesore të projektit përvillimin ekonomik, mbështetja përkryimin e një gjykate komerciale, përdorimi i mekanizmave alternativë të zgjidhjes së kontesteve, ngritja e vetëdijesimit publik dhe përmirësimi i infrastrukturës ligjore", ka dekluaruar ajo. Për më tepër, Zejnnullahu shtoi se arbitrazhi dhe gjykatat nuk e përashtojnë njëra-tjetren. Pavarësisht krijimit të gjykatës

komerciale dhe rritjes së efikasitetit në atë drejtim, arbitrazhi ka rolin e tij në zgjidhjen e kontesteve dhe në asnjë moment nuk duhet të konsiderohet si zëvendësim i gjykatës, por si plotësim i saj. Fëllënza Limani, eksperte ligjore përvillën e Avokatit Shtetëror, ka thënë se arbitrazhi është më pak i zakonshëm në rastet kur institucionet publike lidhin kontratë me një palë private në kontekst vendor. "Ekziston një frikë përfshirjen e klauzolave të arbitrazhit nga institucionet publike, përfshirjet e gjykatës komerciale përvillën e gjithmonë me qëllim të ngritjes së vetëdijes mbi dukuritë që mund të kontribuojnë në konkurrueshmërinë dhe në përgjithësi në të bërit biznes në Kosovë.

përgatitura në fushën e arbitrazhit, marrë parasysh që kjo metodë për zgjidhjen e kontesteve është trend botëror në fushën e të bërit biznes. Tuti, ajo përmendi edhe nevojën për koordinim më të madh ndërinstitucional, si dhe rritje të nivelit të njohurisë mbi arbitrazhin. Qendra e Arbitrazhit e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë do ta vazhdojë organizimin e tryezave mbi vetëdijesimin mbi përfitimet e arbitrazhit komercial përvillën e bizneset, gjithmonë me qëllim të ngritjes së vetëdijes mbi dukuritë që mund të kontribuojnë në konkurrueshmërinë dhe në përgjithësi në të bërit biznes në Kosovë.



Murtezaj përshëndet vazhdimin e partneritetit me GIZ-in

Prishtinë, 29 janar (ER) - Drejtori i ATK-së, Ilir Murtezaj, së bashku me bashkëpunëtorë, ka mbajtur të mëkurën takim me përfaqësuesit e projektit për Reforma në Financa Publike në Kosovë - GIZ, me qëllim të diskutimit të bashkëpunimit të deritanishëm, si dhe për

përcaktimin e aktiviteteve të përbashkëta përvitës në vazdim.

Gjatë këtij takimi drejtori Murtezaj ka thënë se menaxhmenti i lartë i ATK-së çdoherë do të mbetet falënderues përvirjet e vazdueshme nga GIZ-i, i cili ka dhënë

mbështetjen e jashtëzakonshme përvirjet e projekteve të ndryshme, ku në masë të madhe kanë lehtësuar arritjen e objektivave të ATK-së. Me theks të veçantë u përmend mbështetja që kanë marrë përvirjet e ZYRA përvirjet e Gjoba dhe Ndëshkime Administrative (ZGJONA).



Familjet e policëve të rënë në detyrë do të marrin pension nga 300 euro në muaj



Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e së mërkurës, ka ndarë 50 mijë euro për Komunën e Bujanocit dhe ka miratuar vendimin për shtesën e pensionit familjar prej 300 eurosh në muaj për zyrtarët policorë të rënë gjatë kryerjes së detyrës. Po në këtë mbledhje qeveria ka refuzuar kërkesën e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për ndarjen e 5 milionë eurove për Telekomin

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 29 JANAR - Me një minutë heshtje, në nderim të policit të rënë në krye të detyrës, në Zhur të Komunës së Prizrenit, kabineti qeveritar ka miratuar vendimin për ndarjen e mjeteve në vlerë prej 15 mijë eurosh për familjen e policit të vrarë dhe nga 10 mijë euro për policot e plagosur. Me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme është aprovuar "Akti Global për të Drejtat e Njeriut Magnitsky", i cili sanksionon të gjithë shkelësit e të drejtave të njeriut kudo në botë. Ky vendim i Qeverisë së Republikës së Kosovës e bën Kosovën shtetin e parë në Evropën Juglindore që ka miratuar këtë akt dhe e afron në partneritetet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me aleatët ndërkombëtarë në luftën për mbrojtjen e demokracisë dhe të drejtave dhe lirive të njeriut.

Qeveria ka miratuar vendimin për ndarjen e mjeteve financiare si shtesë e pensionit familjar për zyrtarët policorë të rënë në krye të detyrës sipas Ligjit të Policisë. Shuma prej 300 (treqind) eurove

do të ndahet si shtesë e pensionit në bazë mujore, për familjarët e zyrtarëve të rënë në krye të detyrës, siç është përcaktuar në Udhëzimin Administrativ për përcaktimin e rasteve të zyrtarëve policorë të cilët vdesin në detyrë apo në kryerje të detyrës. Vendimi obligon Policinë e Kosovës që në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Financave të zbatojë atë.

Qeveria ka miratuar edhe vendimin për vazhdimin e mandatit edhe për një periudhë trevjeçare për Sekretaren e Përgjithshme të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Rozafa Ukimaj.

Në këtë mbledhje është bërë plotësimi i Bordit të Ndërmarrjes Publike "Kompania për Menaxhimin e Deponive të Mbeturinave", pas dorëheqjes së një anëtari në këtë bord. Duke vendosur sipas kërkesës së Shoqatës së ish të Burgosurve Politikë të Kosovës, qeveria ka ndarë 36 600 euro. Mjetet e ndara do të përdoren për shpenzimet elementare të Shoqatës dhe për përgatitjen e vëllimit të parë të "Leksikonit të të dënuarve politikë shqiptarë të Kosovës në Jugosllavi 1945-1999".

Kabineti qeveritar ka shqyrtuar edhe kërkesën nga Komuna e Bujanocit që Qeveria e Kosovës ta mbështesë financiarisht realizimin e Projektit "Aftësimi profesional i të rinjve në këtë komunë".

Qeveria ka ndarë mjete në vlerë prej 50 mijë eurosh në mbështetje të Komunës së Bujanocit për realizim të këtij projekti që do të krijojë hapësirë dhe kushte për punësimin e të rinjve dhe parandalimin e migrimit të tyre.

Miratimin nga kabineti qeveritar në mbledhjen e së mërkurës ka marrë edhe Rregullorja për ndihmën De Minimis, që nënkupton ndihmat në vlerë të vogël që nuk konsiderohen ndihmë shtetërore dhe nuk janë subjekt i autorizimit të Komisionit të Ndhjmës Shtetërore.

Edhe Rregullorja për performancën e agjencive është miratuar në mbledhjen e qeverisë. Me këtë Rregulloren përcaktohen rregullat e hollësishme dhe procedurat e mbikëqyrjes së agjencive ekzekutive dhe vlerësimi të performancës së tyre. Rregullorja do të jetë e zbatueshme nga të gjitha agjencitë ekzekutive dhe rregullatore si dhe të

institucioneve shtetërore që mbikëqyrin performancën e agjencive ekzekutive.

Kabineti qeveritar ka miratuar edhe vendimin për themelimin e grupit punues për koordinimin e aktiviteteve promovuese, me theks të veçantë brendimin dhe sloganin shtetëror. Grupi punues do të merret me mundësitë e inicimit të procedurave të krijimit të identitetit - identifikues të njohjes për publikun vendor dhe ndërkombëtar, si parakusht për t'i nxjerrë në pah avantazhet konkuruese dhe atë që dallon një shtet nga shtetet e tjera. Grupi punues do ta koordinojë punën ndërinstitucionale të përfaqësimit brenda dhe jashtë vendit për këtë qëllim.

Është aprovuar në parim edhe nisma për lidhjen e marrëveshjes ndërmjet

Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Letonisë për transportin rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave.

Edhe konceptdokumenti për protokollin e shtetit ka marrë miratimin në mbledhjen e kabinetit qeveritar. Konceptdokumenti i rekomandon ndarjen e Protokollit diplomatik nga Protokolli i shtetit. Protokolli diplomatik duhet të vazhdojë të mbetet strukturë brenda Ministrisë së Punëve të Jashtme, ndërsa Protokolli i shtetit të organizohet brenda Zyrës së Kryeministratit. Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar edhe vendimin për shpronësimin për interes publik të pronës së paluajtshme, objektit të ish-Gjykatës Themelore në Prishtinë, për nevojën e akomodimit të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës. Me miratimin e tri vendimeve të veçanta, Qeveria e Kosovës ka aprovuar nismat e Ministrisë së Financave për negocimin e marrëveshjeve ndërkombëtare me Bankën Gjermane për Zhvillim (KfE) për financimin e projektit "Fondi i sfidave të Kosovës - arsimi profesional dhe trajnimi"; negocimin e marrëveshjes me Bashkimin Evropian për pjesëmarjen e Kosovës në Programin e BE-së "Customs 2020" dhe negocimin e marrëveshjes me Bashkimin Evropian për pjesëmarjen e Kosovës në Programin e BE-së "Fiscalis 2020".

Me propozimin e Ministres së Administrimit të Pushtetit Lokal është aprovuar vendimi preliminar për fillimin e procedurave për shpronësim për interes publik të pronave shoqërore në Komunën e Gjakovës dhe të cilat preken nga realizimi i projekteve të interesit publik. Po në këtë mbledhje qeveria ka refuzuar kërkesën e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për ndarjen e 5 milionë eurove për Telekomin. Ministri i Financave, Lulzim Rafuna, ka kërkuar sqarim në lidhje me këtë pikë, duke theksuar se për këtë vit është e pamundur ndarja e këtyre mjeteve.


Komuna e Prizrenit me reforma administrative për shërbime më të shpejta për qytetarë

PRIZREN, 29 JANAR (ER) - Me qëllim të përmirësimit dhe thjeshtimit të procedurave administrative për qytetarë dhe biznese, Komuna e Prizrenit, në bashkëpunim të ngushtë me Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC), pjesë e Grupit të Bankës Botërore, është duke u angazhuar përmirësimin e procedurave administrative të panevojshme dhe pa bazë ligjore, përshpejtmin e procedurave, uljen e kostove të tyre, si dhe evitim e kërkesave për dokumente të panevojshme. Projekti "Klima e investimeve në Kosovë", i cili ka filluar të implementohet nga nëntori i vitit 2018, kur është nënshkruar kontrata e marrëveshjes nga

kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka dhe drejtori rajonal i IFC-së, Thomas Lubeck, është duke u financuar nga Qeveria e Zvicrës. "Në këtë drejtim fillimi është janë identifikuar 161 procedura administrative, për të cilat është bërë analiza ligjore dhe ekonomike, në mënyrë që më pas të jepen rekondimet për thjeshtimin e tyre. Të gjeturat kryesore janë prezantuar para kryetarit Haskuka dhe drejtoreve të Komunës së Prizrenit në raportin e titulluar 'Analiza e Procedurave Administrative', i cili është ndjekur nga takime të shumta, ku bashkërisht janë diskutuar dhe shqyrtuar miratimet e rekondimeve për

thjeshtim të procedurave", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.

Sipas këtij njoftimi, deri më tanë Komuna e Prizrenit ka bërë dy ndryshime me vlerë të madhe në drejtim të thjeshtimit të procedurave administrative. "Me ndryshimet e bëra, për çdo dokument, qytetari arrin t'i kursejë 0.20 euro si dhe minimumi rreth 15 minuta kohë pasi qytetarit i duhet që ta lë radhën e prites në mënyrë që të dalë jashtë objektit komunal për ta fotokopjuar letërnjoftimin dhe të kthehet përsëri në radhë. Në analizat e bëra nga Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC), gjatë vitit 2018 nga gjithsej 202 150 aplikime për nxjerrjen e dokumenteve të Gjendjes Civile,



vetëm kërkesa për të sjellë fotokopjet e letërnjoftimeve u ka kushtuar aplikuesve 154 139 euro, gjë që tanë do të kursetet nga qytetarët e komunës", ka njoftuar kjo komunë. Komuna e Prizrenit ka ulur dukshëm numrin e bizneseve që

paguajnë taksën vjetore të veprimitarisë komunale, përkatësisht nga 4 316 në 221 biznese. "Si rrjedhojë, bizneset kursejnë rreth 610 847 euro për një vit", është thënë në njoftimin e komunës që drejtohet nga Mytaher Haskuka.

Nënshkruhet marrëveshja për izolimin termik të shtëpive për familjet në nevojë

DRENAS, 29 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka nënshkruar marrëveshje mirëkuptimi me Marko Kosir, udhëheqës i projektit "Subvencionet për Eficiencë të Energjisë në Kosovë (SEEK)" që është në kuadër të Programit të Pragut për Kosovën të MCC-së, i zbatuar nga Fondacioni i Mijëvjeçarit të Kosovës.

Me rastin e nënshkrimit të kësaj marrëveshje të mirëkuptimit, kryetari Lladrovci ka vlerësuar se realizimi i këtij projekti është



shumë i qëlluar, kur dihet që dëmet nga lufta e fundit kanë qenë të mëdha në Drenas. "Të gjithë qytetarët që nuk kanë mundësi ta bëjnë izolimin termik të shtëpive të veta me masa eficiente, përmes

këtij projekti do të kenë mundësi që ta përfitojnë zbatimin e masave eficiente në favor të energjisë, masa njëkohësisht të këruara me standartet e BE-së, t'i reduktojnë pastaj edhe shpenzimet për energji elektrike, por edhe një mundësi e mirë për ato familje që janë në nevojë që shtëpitë e banimit të tyre t'i izolojnë termikisht më mirë, që fëmijët e tyre të mos rrezikohen nga sëmundjet që vijnë nga të ftotit", ka thënë kryetari Lladrovci. Ndërsa udhëheqësi i projektit, Marko

Kosir, ka falënderuar kryetarin Lladrovci për gatishmërinë që ka treguar për ta përkrahur këtë projekt i cili ka të bëjë direkt me mirëqenien e ekonomive familjare që kanë nevojë për ambientet e tyre të jetës. Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje të mirëkuptimit, që do të zbatohet nga Komuna e Drenasit dhe Fondacioni i Mijëvjeçarit të Kosovës, ka për qëllim ta zgjelojë konsumin e energjisë elektrike në sektorin e banimit.



Muharremaj pret në takim disa nga nxënësit e shkollës "Abdyl Ramaj"

SUHAREKË, 29 JANAR (ER) - Disa nxënës të drejtimit juridik në Shkollën e Mesme Profesionale "Abdyl Ramaj" së bashku me profesorin Aziz Bytyqi kanë takuar të mëkurën kryetarin e Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj. Me këtë rast, Muharremaj ka thënë se kjo shkollë do ta ketë gjithmonë përkrahjen e tij. "Me nxënësit e

Shkollës së Mesme Profesionale 'Abdyl Ramaj', Drejtimi Juridik, diskutuan bashkë për çështje të ndryshme. Biseduan për kushtet në shkollë dhe për punën praktike profesionale në institucione të ndryshme. Do ta kenë gjithmonë mbështetjen time për angazhimë edukuese dhe profesionale", ka thënë Muharremaj pas takimit.

Klina nderon dëshmorët dhe martirët e kombit

KLINË, 29 JANAR (ER) - Në 21-vjetorin e rënies heroike të dëshmorëve të kombit, Ilir Merturi, Vesel Avdyli dhe Naim Gashi, së bashku me 21 dëshmorë të tjerë dhe 9 martirë në Rogovë të Hasit, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Klinit, Fadil Gashi, i shoqëruar nga bashkëpunëtorë të kësaj komune, komandanti i Policisë në Klinë, përfaqësues të organizatave të dala nga lufta e UÇK-së si dhe qytetarë dhe familjarë të të ndjerëve, kanë bërë homazhe dhe kanë vendo-

sur kurora me lulesh te varrezat e dëshmorëve në Kompleksin Memorial "Kodra e Kuqe" në Grabanicë.

Për ta nderuar veprën heroike të këtyre dëshmorëve të kombit, Komuna e Klinit ka organizuar manifestimin përkujtimor dhe kulturor "Flaka e Janarit", i cili organizohet në bashkërendim të manifestimit qendror që iu kushtohet veprimitarëve Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka.



Fizika dhe kimia simetrike, udhëtim drejt universit (13)

Orbitat e rrotullimit të trupave qiellorë



Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan

Sferat e fushave të lartë përmendura e kanë origjinën më komplekse se sa mendohet te trupat qiellorë rrëth të cilëve rrotullohen trupa të tjera qiellorë.

Formës sferike e formojnë cikloni me ndihmën e tornados elektromagnetike. Këto fenomene veprojnë njëkohësisht me forca tërheqëse nga periferia në drejtim të qendrës. Ashtu sikur

është svaruar në botimin e parë te ("Epoka e re" 16 korrik 2019), ku ciklonet shpërndahen në drejtim të boshtit (x) kurse tornadot elektromagnetike shpërndahen në drejtim të boshtit (y). Prandaj, pa marrë parasysh këndin e këtyre dy fenomeneve në të cilin

ndodhen brenda një trupi qiellorë, ato jepin një formë sferike sikur edhe fushave magnetike qoftë primare, sekondare dhe fushës antimagnetike por gjithashtu edhe trupit qiellorë i jepin një formë sferike ashtu sikur shihet në figurën 19.

Si po shihet tornadoja elektromagnetike me forcë i shtyp valët e ciklonit që janë të shpërndara në drejtim të boshtit (x), por edhe cikloni me forcë e shtyp tornadon elektromagnetike. Kurse forca e tornados elektromagnetike e shndërron një formë të diskut ciklonin e trupit qiellorë. Boshti i rrotullimit të një trupi qiellorë është perpendikular me diskun e

ciklonit të atij qiellor. Kjo forcë ndikon që trupat qiellor të zbrasin në një orbitë të rregullt dhe të rrotullohen rrëth atij trupi qiellorë. Ashtu sikur tornadoja elektromagnetike e tokës që e ka zbritur hënën në diskun e ciklonit të tokës. Forca e ciklonit të tokës është një forcë me intensitet ekstrem të lartë, sidomos në 200 kilometrat e fundit mbi sipërfaqen e tokës. Shkaku i kësaj force ekstreme është svaruar në botimet e "Epoka e re" 2016.

Prandaj, bazuar në forcën e ciklonit të tokës, që njihet si forca gravitacionale e tokës, dhe forcën e tornados elektromagnetike fusha magnetike sekondare apo magnetosfera e merr formën e një sfere që e mbështjellë planetin e tokës, dhe quhet Sfera e fushës magnetike sekondare të tokës (SBs).

R1- Sfera e fushës magnetike sekondare të tokës (SBs)

Sfera e fushës magnetike sekondare e tokës (SBs) apo magnetosfera e tokës sot shkenca e njeh sikur si një fushë magnetike të tokës përbëhet nga mikrogramcat (β), (δ) dhe (μ) që posedojnë një (adn-x). Kështu që kjo sferë e përbërë nga këto mikrogramcae mbron tokën nga erërat diellore, si dhe rrezatimeve të ndryshme që vijnë nga gjithësia. Duke u bazuar në natyrën e krijimit të tokës, dhe të dhënat shkencore, thuhet se magnetosfera e tokës ka një rrëze rrëth nga 800 deri 60 000 km nga sipërfaqja e tokës. Edhe pse saktësish nuk mund ta dimë se sa është rrezja e materialeve feromagnatike, i cili e rritet vlerë e nivelit të energjisë së këtyre grimcave, dhe kjo ndikon




Fig 19

ta bënte vizuale përmes ngjyrave sferën e fushës magnetike sekondare e tokës (SBs).

Pasi sfera e fushës së ciklonit me ndihmën e tornados elektromagnetike të tokës, kanë një rreze prej qindra mijëra kilometresh, nga qendra e tokës, këto forca tërheqëse që ushtrojnë presion mbi fushën magnetike simetrike sekondare të tokës (SFs), të cilat tentojnë ta bllokoinjë edhe polet magnetike të tokës të mos buroi fusha magnetike simetrike. Por pasi nga toka buron një fushë magnetike simetrike, e krijuar nga vetërigjenerimi i grimcave të materialeve feromagnetike, si dhe buron nga të dy polet magnetike të tokës, është e pa mundshme të pengohet. Prandaj, forca e ciklonit të tokës sado e fortë që të jetë, nuk mund ta bllokoi një fushë magnetike simetrike sekondare të buroi nga të dy polet magnetike të tokës ashtu sikur shihet në figurën 20.


Në të kundërtën e kësaj forca e ciklonit të tokës dhe tornados elektromagnetike të tokës, mund ta irisin edhe më shumë nivelin energetik të mikrogramcave sekondare, brenda protoneve elektroneve dhe neutroneve të materialeve feromagnatike, i cili e rritet vlerë e nivelit të energjisë së këtyre grimcave, dhe kjo ndikon

në rritjen e rigjenerimit i cili transformohet në fushën magnetike simetrike të tokës. Prandaj, ky është një burim i dhunshëm, dhe e pa mundshme të bllokohet nga forca e ciklonit të tokës. Këtë e ndihmon edhe fusha antimagnetike e cila ka një forcë shumë here më të madhe se sa fusha magnetike sekondare ashtu sikur shihet në figurën se sa fusha magnetike primare dhe sekondare. Fusha magnetike sekondare dhe fusha antimagnetike kanë kahje dhe drejtime të kundërtë në mes veti, kurse të dyja quhen fusha të dhunshme, dhe në asnjë rrëthanë nuk mund të bllokohen nga forca tërheqëse e fenomeneve të ciklonit dhe tornados elektromagnetike. Në këtë mënyrë rrëth tokës formohet shtresa e parë në formë sferike që e mbështjellë tokën, dhe quhet Sfera e fushës magnetike sekondare të tokës (SBs).

Zgjerimi i fushës magnetike sekondare të tokës, magnetosferës

Magnetosfera e tokës nga

formimi e deri tani zgjerohet pandërprerë, pa marrë parasysh nivelin e fushës magnetike simetrike sekondare të tokës, por ne nuk kemi mjete ta matim saktësish se sa centimetra zgjerohet brenda një viti. Por një matje shumë të saktë sot na tregon largimi i hënës nga toka. Ky është një argument i pa kontestueshëm se sfera e fushës magnetike sekondare të tokës është duke u rritur rrëth 4 centimetra në vit. Rritja e rrezes së fushës magnetike sekondare të tokës e rritë nivelin energetik të të mikrogramcave të fushës antimagnetike të tokës, e cila shndërrohet në forcë shptytëse, duke e rritur rrezen e veprimt të saj, dhe duke larguar të gjithë trupat nga sipërfaqe e tokës nga 4 cm, ne mesin e të cilëve është edhe hëna. Edhe pse sot e dimë se sa rritet shtresa e sferës magnetike sekondare të tokës, dhe forca e fushës antimagnetike, ne nuk mund ta dimë se si janë rritur gjatë mijëvjeçarit të fundit, sepse po ta dinim këtë rritje të magnetosferës, kjo na tregonte afersisht se toka është një trup shumë ma i ri se sa mendohet. Kurse kthimi i tokës në planet të banueshëm është shumë i ri dhe nuk mund t'i kaloi as qindëmilionat e një dore. Kurse sjellja e bimëve vegjetele është shumë më e vonshme, duke pasuruar me vonë me kafshë të llojeve të ndryshme duke përfshi edhe dinaosaurët, e që zhdukja e tyre nuk ka asgjë të përbashkët me rënien e ndonjë metore gjigant ashtu sikur mendohet sot. Kurse në fund sjellja e njeriun modern ashtu sikur jemi ne sot. Prandaj, e gjithëjeta në tokë është vendosur nga jashtëtokësorët, që nuk kanë asnjë ndryshmi nga ne, mund të janë në mesin e tonë, por ne si njohim, mund të vijnë e të shkojnë e ne si shohim. (VIJON)



→ **Forca e ciklonit të tokës- forca gravitacionale**

← **Fusha antimagnetike**
← **Fusha magnetike sekondare**

Fig 20

Pikëpamjet e profesor Rexhep Qosjes për Albanologjinë (4)

V. Kontributet në fushë të historisë së letërsisë

Prof. asoc. dr. Myrvete DRESHAJ-BALIU
Prof. dr. Begzad BALIU

Duke qenë historian i letërsisë, në të vërtetë bartës i arritjeve të rëndësishme të kohës në fushë të kësaj dijeje, sado jo në ato përmasa që do t'i arrijë më vonë. Profesor Qosja konceptet për studimin e letërsisë shqipe në projektin e tij i kishte lënë të fundit.

Në fushën e studimit të letërsisë shqipe, ndërkaq, është e nevojshme të vazhdojmë punën rreth mbledhjes së të dhënave dhe të shkrimeve të shkrimitarëve shqiptarë, -po jo vetëm - nga trualli i Kosovës dhe rreth ngritisë sa më komplete të arkivit të krijuarve të traditës dhe të kohës sonë. Në këtë drejtim është e nevojshme të hartoher leksikoni i shkrimitarëve që, në mungesë të enciklopedive shqiptare, do të plotësonë kërkuesat e përditshme për informata letrare. Krahas kësaj pune duhet të studiohen: poetika e shkrimitarëve të veçantë; evoluciuni tematik; evoluciuni stilistik; zhanret dhe tipat letrare; evoluciuni i ritmit në poezinë shqipe; formacionet stilistike në diakroni dhe në sinkroni; çështjet metodologjike dhe praktike të periodizimit; marrëdhëniet e letërsisë shqipe me letërsinë evropiane sipas periudhave letrare. Në mënyrë të veçantë është e nevojshme të ndiqet struktura e rrjedhave të letërsisë së sotme shqipe dhe të hetohen prirjet e saj karakteristike. Me këto studime të veçanta problemore dhe historike letrare do të duhej të përgatitej hartimi i historisë së letërsisë shqipe, në bazat e poetikës strukturale historike". Profesor Qosja gjatë kësaj kohe do të ideojë projektin e madh të Historisë së letërsisë shqipe (Romantizmi I, II, III), i cili për nga rëndësia e trajtimit dhe e sqarimit teorik të disa problematikave të procesit historiko-letrare në të, mbetet ende një nga nevojat e rikonceptimit të përgjithshëm të Historisë së letërsisë shqiptare sot. Në fushë të interpretimit, tipologizimit, teoritizimit dhe vlerësimit të procesit letrar shqiptar, në fushë të mendimit largvajtës historik, Rexhep Qosja është i njojur përsintezat e mëdha shkencore në fushë të historisë së letërsisë e të mendimit teoriko-letrar të kësaj dijeje. Studimet e para të kësaj natyre dalin që në veprën e parë Episode letrare (1987), por zënë vend të theksuar në vëllimet Dialogë me shkrimitarët (1968) dhe Kontinuitete (1972) dhe

identifikojnë historianin e letërsisë me monografinë Asdreni - jeta dhe vepra e tij (1972), për të vazhduar me vepra të tjera të kësaj natyre gjatë një jete të tërë: Shkrimitarë dhe periudha (1975), Prej tipologjisë deri te periodizimi (1979), Nocione të reja albanologjike (1983), Historia e letërsisë shqipe I-III (1984/1986), Porosia e madhe (1986), Tri mënyra të shkrimit shqip (2004), Semantika e ndryshimeve historiko-letrare (2009), si dhe vepra të tjera, në të cilat ku më pak e ku më shumë ka trajtuar autorë, vepra dhe periudha historiko-letrare. Me këto vepra dhe me të tjera të kësaj natyre, ai e ka bërë për herë të parë sintezën e madhe të historisë së popullit shqiptar, të letërsisë dhe të kulturës së tij, e kjo do të thotë të albanologjisë, në kuptimin e plotë të fjalës, pa ndarje kufijsh politikë, kulturë dhe historikë, duke i parë ata si një të tërë me zhvillimet historike të Evropës dhe si një etni sociokulturore, etnopsikologjike, politike e gjuhësore në zhvillimin e qytetërimit të tyre. Në këtë rrjedhë, veprën e tij për më shumë se gjysmë shekulli e ka shquar koncepti antidogmatik dhe qasja moderne e humumimit dhe studimit. Në veprat me karakter monografik dhe në ato me studime të veçanta Profesor Qosja ka realizuar si një asnjë fushë tjetër të albanologjisë prirjet moderne të studimit të letërsisë shqipe, ka identifikuar metodat më bashkëkohore të studimit të saj, ka bërë periodizimin e saj sipas teorive moderne me të cilat janë

bërë periodizimet e letërsive fjalje dhe europiane, ka parë elementet e përbashkëta, ndikimet dhe dallimet e letërsisë shqipe me atë europiane, rrjedhat historike të zhvillimit të saj, si dhe ka standardizuar një varg nacionesh, termash e neologizmash për studimin e saj. Duke e konceptuar, përkatësisht projektuar historinë e letërsisë shqipe dhe duke iu qasur asaj në diakroni e sinkroni, ai ka mundur të studiojë njëren prej periudhave më homogjene të letërsisë shqipe dhe rrafshet e saj, të cilat ai i identifikon si: struktura e erudicionit letrar, shkencor dhe filozofik; struktura e pikëpamjeve përgjuhën dhe përdorimin e saj; struktura e miteve që krijojnë shkrimitarët e kësaj periudhe dhe e topikës që sjell përsëritja e temave, e mendimeve dhe e ndjenjave të njëjtë; struktura e aspektave ligjëimore; struktura figurative, metrike dhe ritmike e vargut dhe tipologjia e tij; struktura tipologjike e gjinive, e llojeve dhe e formave të poeziës lirike, të poeziës liriko-epike, të poeziës epike, të prozës, të prozës letraro-shkencore dhe të dramës. Në të vërtetë, duke u marrë me strukturën hapësinore të romantizmit, ai merret me tema që në shikim të parë kanë karakter historik e kulturor, si atdheu dhe kolonitë, kolonia e arbëreshëve të Italisë, kolonia e Stambollit, atdheu, çintegrimi i romantizmit etj.; duke u marrë me shtrirjen kohore të romantizmit, ai merret me disa prej përbërësve

historikë, periodizues e kulturore të tij, si: dy etapa të romantizmit, iluminizmi kombëtar, faktorët ndarës dhe faktorët bashkues, faktori dialektor gjuhësor, faktori fetar, faktori kryesor bashkues, letërsia dhe opinioni, kultura kombëtare, struktura kohore dhe qenia estetike etj.; duke studiuar veçoritë e strukturës gjuhësore të romantizmit ai merret në mënyrë të veçantë me traditën dhe shumëgjuhësinë e teksteve të shkrimitarëve të kësaj periudhe, shkaqet e shumëgjuhësë romantike (italiane, greke, turke, franceze etj.) dhe tejkalinin e saj; duke vlerësuar erudicionin letrar, filozofik dhe shkencor të shkrimitarëve të letërsisë së romantizmit shqiptar ai ka bërë tipologjinë e strukturës sinkronike dhe diakronike të këtij erudicionit, nga interesimet e tyre për letërsitë antike greke dhe romake, deri te evopeizimi i saj.


Duke bërë sintezën e madhe të historisë së letërsisë në rrafshin diakronik e sinkronik Profesor Qosja ka bërë të mundur edhe pamjen e përbërësve të letërsisë populllore brenda saj, nga romantizmi dhe konteksti folklorik e historik deri te tejkalimi i ndjeshmërisë dhe i modeleve folklorike, ndërsa duke e parë rolin e gjuhës në jetën mendore dhe letrare në këtë periudhë ai ka diskutuar disa nga vlerat historike, stilistike dhe ndjenjore të filozofisë së saj, si dhe përpjekjet e shkrimitarëve të kësaj periudhe për pastërtinë e gjuhës prej barbarizmave dhe krijimin e neologizmave etj. Më parë se sa të merrej me poetikën e veprës së shkrimitarëve të romantizmit, duke e bërë tipologjinë e saj veç e veç, Profesor Qosja ka sjellë një pamje sintetike të miteve romantike, brenda të cilit janë përbledhur veçoritë materiale e shpirtërore të popullit shqiptar, kujtesa historike, historia e letrarizuar, mitet përgjuhën etj., deri tek çintegrimi i tyre, si kusht për të kaluar në periudhën e realizimit.

Do të duhet shumë kohë që Historia e letërsisë shqipe në përgjithësi dhe periudha e romantizmit në veçanti, të ketë një sintezë të kësaj natyre, brenda së cilës të jetë bërë tipologjia e veçorive teorike, stilistike e letrare e krijimtarës së romantikëve shqiptarë, si: tipologjia e lirikës dhe përbërësit e saj, tipologjia e liriko-epikës dhe e epikës, tipologjia e prozës, e prozës letrare-shkencore dhe e dramës, trajtat e ligjërimit, struktura e figurave, struktura rrokjesore dhe ritmike e vargut,

romantizmi shqiptar dhe romantizmi evropian etj. Duke shkruar për veçoritë historike të krijimtarisë letrare të periudhës së romantizmit Profesor Qosja ka shkruar në mënyrë të veçantë për disa aspekte teorike, gjuhësore, letrare dhe estetike të saj, sikur janë: poezia atdhetare, poezia e dashurisë, poezia meditative, tingëllima, odja, himni, marshi, elegjia, vajtimi, satira, poema lirike, kënga epike, epopeja në prozë, proza e vonuar, romani, historia e letrarizuar, tregimi, fejtoni, aforizmi dhe aforizmi i poetizuar, kritika letrare, polemika, jetëshkrimet dhe memoaret, tipat e dramës, teatri, thënia gjuhësore dhe lexuesit e saj, parimi retorik i stilit, ligjërimi vlerësues, ligjërimi, etosi dhe patosi, ligjërimi dhe stilet funksionale, figurat dhe formacioni stilistik, personifikimi dhe strukturat emocionuese të vargut, krahasimi, pozitat e krahasimit në strukturën e vargut, rolin e krahasimit në strukturën e vjershës, epititin, strukturën patetike dhe retorike të figurave romantike, strukturat mbizotëruese rrokjesore dhe ritmike, ritmet e strukturave të shkurtra rrokjesore, ritmet e strukturave të mesme rrokjesore, ritmet e strukturave të gjata rrokjesore, strukturat rrokjesore dhe ritmet e mangëta, strukturat ritmike dhe rrjedhimet gjuhësore, konteksti horizontal evropian i romantizmit shqiptar, konteksti vertical evropian i romantizmit shqiptar etj.

E parë në kontekstin historik dhe kulturor e shkencor të kohës, Historia e letërsisë shqipe, profesor Qosjes i ka dhënë dimensionin e studiuesit të përmasave kombëtare dhe më gjerë. Në përmasa kombëtare i ka dhënë vendin e idhullit, në të cilin janë bashkuar kombëtarja dhe evropiania, më parë se sa këtë epitet ta merrte pak vite më vonë kur në mënyrë të veçantë u bë përfaqësues i popullit të tij në ringritjen historike: çlirimtare në Kosovë dhe demokratike në Shqipëri. Sigurisht kjo është edhe arsyja pse në këtë ecje, në këtë rrugëtim historik, profesor Qosja me jetën dhe me veprën nuk e përfaqësoi vetëm idhullin e shqiptarizmës: Naim Frashërin, po sintezën e madhe të kësaj periudhe të lavdishme historike, - romantizmin. Kjo, sigurisht është edhe arsyja kuptimore, pse vepra e tij shkencore, letrare dhe politike e ka udhëhequr këtë idhullin e shqiptarizmës.

Naim Frashërin, po sintezën e madhe të kësaj periudhe të lavdishme historike, - romantizmin. Kjo, sigurisht është edhe arsyja kuptimore, pse vepra e tij shkencore, letrare dhe politike e ka udhëhequr këtë idhullin e shqiptarizmës.





The banner features the RC Cola logo at the top left. Below it, a large yellow box contains the text "ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS". To the right of the text, there are two products: a blue can and a dark plastic bottle of RC Cola. The background is a dark blue textured surface.

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L Lebanon, Sales
- ★ Kotola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales



The advertisement features a circular tin of Meka Halal Food Pashtetë Pule. The tin is orange with a white lid. It shows a slice of pate with a red spread and some herbs. Text on the tin includes "MEKA HALAL FOOD", "PASHTETË PULE", "gluten free", "100 % mish pule", and "ciliësi e garantuar pa konservues". The background is orange with white, flame-like patterns.

E rrallë

I riu kapet me 30 celularë të fshehur në pantallona

Policia holandeze ka zbuluar gjatë një koncerti të rokut vjedhjen e 30 telefonave celularë nga një person i cili i kishte fshehur në pantallona të çiklizmit. Ata dyshojnë se personi në fjalë është një 34-vjeçar i cili besohet se është i përfshirë në një grup grabitësish. Ai u ndalua pasi fansat e koncertit lajmëruan policinë, tekxa kjo



e fundit bllokoi të gjitha daljet. Policia dërgoi masa shtesë pas një paralajmërimi nga policia belge. 30 telefonat celularë u vodhën në zonën Antwerp-a.

FOTO E DITES



Një tufë elefanti shihet duke kërkuar ushqim në një zonë të pyllëzuar në periferi të Gauhatti në Indi. /AP/

E jashtëzakonshme

Shkencëtarët zbulojnë katër lloje të peshkaqenëve që mund të 'ecin'

Disa peshkaqenë mund të ecin, por jo ata të frikshmit. Ata gjithmonë kanë ecur, ose diçka e tillë, prej 9 milionë vjetësh. Megjithatë, shkencëtarët që merren me studimin e peshkaqenëve për vite me radhë kanë analizuar ADN-në e të vërmitt peshkaqen të njobur që mund të ecet për ta përcaktuar kohën e evoluimit të tyre. Ata gjetën katër lloje të tjera



peshkaqenësh. Speciet më të reja mund të kenë evoluar 2 milionë vjet më parë. Peshkaqenët që ecin, të quajtur edhe peshkaqenë 'epauletës' për njollat e tyre që ngjason më dekorat ushtarake, 'ecin' nëpërmjet mollëzave të tyre muskulore për t'u ushqyer me peshq të vegjël përgjatë shkëmbinjve nënborë të cekët dhe me barishtet e detit.



DASHI
Hëna dhe Mërkuri ushtrojnë një ndikim të fortë në shenjën tuaj. Ju mund të mbështeten në marrëveshje të reja profesionale dhe shoqata të reja biznesi.



DEMI
Pjesa e parë e ditës do të jetë pozitive dhe dashamirëse sa i përket punës dhe kontaktive.



BINJAKËT
Gjëra interesante ju presin në punë, me kalimin e Hënës në Dashi, një shenjë miqësore që gjithmonë ju bën të zbuloni diçka të re.



GAFORRJA
Përfitonin nga pjesa e parë e ditës, më e favorshmja, nëse keni projekte në duar që i konsideroni të rendësishme.



LUANI
Nëse keni liri në profesionin tuaj lëreni veten tuaj të udhëhiqet nga intuita sepsë është e sigurt që do ta merrni drejtimin e duhur.



VIRGJËRESHA
Deri rreth orës 1 pasdite Hëna në Peshqit ju ngadalëson në iniciativa, zgjon probleme shëndetësore sezionale dhe nuk është e përshtatshme për veprimtarit artistike.



PESHORJA
Yjet flasin për një qetësi të përhapur mendore që mund t'ju çojë në veprim efektiv për t'i arritur objektivat e dëshiruar: në studim, në punë apo në biznes!



AKREPI
Marrëdhënja mes çiftit rifillon falë një partneriteti më të gjallë dhe më të tërheqës. Kultivoni mendime optimiste, argëtohuni dhe mos hezitoni t'i përkushtoheni asaj që ju pëlqen.



SHIGJETARI
Ju keni shumë punë për të bërë, por përpinquni të mos nxitoheni, bëjini gjërat tuaja me qetësi.



BRICJAPI
shëm se zakonisht për nevojat e të dashurit tuaj. Nëse jeni beqar, një takim do t'ju sjellë të dridhura në jetën tuaj.



UJORI
Gjeni kohë për t'u çlodhur, kjo do të jetë një ditë shumë e këndshme nëse mund të përfitonin nga ajo. Dashuria premton disa filtre dhe njohje të reja.



PESHQIT
Ditë me dy ftyra. Paradite do të keni një ditë shumë të bukur në punë, ndërsa pasdite do të ndryshojë gjithçka ku do të keni mosmarrëveshje me partnerin/en ose me miqtë.

BARSOLETA E DITËS



- Bir, i kam thirr mbrëmë zjarrfikësit e kam ba hajgare me ta.
- Qysh more?! E pastaj çka bane?
- Pastaj ia shtina flakën shpisë, se thashë mos po e lajmërojnë policinë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

Regjia: Jake Kasdan



Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min
Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj

Regjia: J.J. Abrams



Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea DuVall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu

	DASHI Hëna dhe Mërkuri ushtrojnë një ndikim të fortë në shenjën tuaj. Ju mund të mbështeten në marrëveshje të reja profesionale dhe shoqata të reja biznesi.
	DEMI Pjesa e parë e ditës do të jetë pozitive dhe dashamirëse sa i përket punës dhe kontaktive.
	BINJAKËT Gjëra interesante ju presin në punë, me kalimin e Hënës në Dashi, një shenjë miqësore që gjithmonë ju bën të zbuloni diçka të re.
	GAFORRJA Përfitonin nga pjesa e parë e ditës, më e favorshmja, nëse keni projekte në duar që i konsideroni të rendësishme.
	LUANI Nëse keni liri në profesionin tuaj lëreni veten tuaj të udhëhiqet nga intuita sepsë është e sigurt që do ta merrni drejtimin e duhur.
	PESHQIT Ditë me dy ftyra. Paradite do të keni një ditë shumë të bukur në punë, ndërsa pasdite do të ndryshojë gjithçka ku do të keni mosmarrëveshje me partnerin/en ose me miqtë.
	PESHORJA Yjet flasin për një qetësi të përhapur mendore që mund t'ju çojë në veprim efektiv për t'i arritur objektivat e dëshiruar: në studim, në punë apo në biznes!
	AKREPI Marrëdhënja mes çiftit rifillon falë një partneriteti më të gjallë dhe më të tërheqës. Kultivoni mendime optimiste, argëtohuni dhe mos hezitoni t'i përkushtoheni asaj që ju pëlqen.
	SHIGJETARI Ju keni shumë punë për të bërë, por përpinquni të mos nxitoheni, bëjini gjërat tuaja me qetësi.
	BRICJAPI shëm se zakonisht për nevojat e të dashurit tuaj. Nëse jeni beqar, një takim do t'ju sjellë të dridhura në jetën tuaj.
	UJORI Gjeni kohë për t'u çlodhur, kjo do të jetë një ditë shumë e këndshme nëse mund të përfitonin nga ajo. Dashuria premton disa filtre dhe njohje të reja.


Miley Cyrus dhe Liam Hemsworth zyrtarisht të shkurorëzuar



Trembehjetë muaj pasi thanë "Po", Miley Cyrus dhe Liam Hemsworth janë zyrtarisht të shkurorëzuar. "TMZ" -ja ka raportuar se gjykata e ka vërtetuar marrëveshjen për shkurorëzim që tashmë ish-cifti e kishte dorëzuar në muajin dhjetor të

vitit 2019. Si pjesë e kësaj marrëveshje, Cyrus do t'i mbajë kafshët e tyre. Procedura e divorcit ishte e thjeshtë për Cyrus dhe Hemsworth, pasi ata nuk kishin fëmijë dhe, po ashtu, kishin nënshkruar një marrëveshje paramartesore.

Xhaketa prej kashmiri që Selena Gomezi s'po di ta heqë nga trupi



Me statusin e të qenit e famshme ke qasje edhe në shumë veshje të stilistëve të famshëm. Pra, bie shumë në sy kur një person i listës 'A' vesh pa ndalë të njëjtën rrobë. Duket që Selena Gomez është dashuruar së fundi

në xhaketën e saj prej kashmiri të markës "Makena" në Honolulu. Ajo u fotografua nga paparacët në dhjetor të vitit të kaluar derisa ishte në Londër duke dalë nga hoteli dhe me atë xhaketë nisi vitin 2020 ku së fundmi u pa edhe në NYC.



Hailey Baldwin me fustan seksi në premierën e dokumentarit për Justin Bieberin

Hailey Baldwin duket se është kujdesur shumë për pamjen e saj në premierën e serisë së dokumentarëve për burrin e saj. Modeluesja 23-vjeçare ka ecur në tapetin e kuq me Justin Bieber për të festuar lansimin e shout të këtij të fundit në "YouTube"

"Justin Bieber: Seasons" e veshur me një fustan të zi shumë seksi. Fustani i mbuluar me xixa ishte nga koleksioni i pranverës përvitin 2020 nga Zuhair Murad, të cilin e kishte kombinuar me sandale me rripa, po ashtu të zeza, nga Sergio Rossi.

Kesha publikon "Tonight"



Kesha po bëhet gati që të ofrojë muzikë të re. Këngëtarja 32-vjeçare ka publikuar edhe një

këngë të quajtur "Tonight", pjesë e albume mit të saj të ardhshëm "High Road", i cili pritet të dalë në shitje këtë të premte.

‘Dardanët’ në aksion

Mesfushori Valon Berisha dhe mbrojtësi Florent Hadergjonaj pritet të ndërrojnë skuadër në këtë afat kalimtar për të gjetur më shumë hapësirë për të luajtur, derisa Fenerbahçe e ka në opsjon shitjen e sulmuesit Vedat Muriqi në mënyrë që t'i shlyejë disa borxhe

EPOKA
ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 29 JANAR - Kapiteni i Kosovës në futboll, Amir Rrahmani dhe ish-lojtar i Përfaqësueses, Donis Avdijaj, nuk pritet të jenë lojtarët e vetëm që kanë lëvizur apo nënshkruar për një klub tjetër në afatin kalimtar të janarit, pasi rrugës së tyre janë edhe disa futbollistë të tjera.

Mbrojtësi i dikurshëm i Drenicës nga Skenderaj, Amir Rrahmani, ka bërë hapin më të madh në karrierë, pasi ka ndëshkuar ditë më parë për skuadrën gjigante të Italisë, Napoli. Qendërbrojtësi deri në verë do ta dështë fanellën e Veronës e më pas do t'i bashkohet skuadrës së re. Ndërsa futbollisti me tipare sulmuese, Donis

Avdijaj, ditë më parë u nda me Trabzansporin për shkak të minutave të paktë dhe firmosi për skuadrën skoceze, Hearts. Lojtari i radhës që pritet të ndryshojë klub është mesfushori Valon Berisha, i cili do të largohet në këtë afat kalimtar nga Lazio dhe karrierën pritet ta vazhdojë në Bundesliga. Lazio ka arritur marrëveshje për kalimin e Berishës në Fortuna Dusseldorf në formë huazimi dhe me të drejtë blerje në fund të këtij edicioni. Berisha për 7.5 milionë euro ishte transferuar nga Salzburgu në skuadrën e italiane, por në Lazio ai nuk arriti të sigurojë një vend të titullarit përfaktin se në të shumtën e kohës kishte probleme me lëndime. Ashtu sikurse Berisha në formë huazimi pritet të ndërrojë klub edhe anësori Florent Hadergjonaj. 25-vjeçari është

pjesë e Huddersfield Townit nga viti 2018, por mungesa e minutave në këtë edicion ka ndikuar që ai të vendosë të transferohet në Turqi, përkatësisht në skuadrën Kasimpasa. Ndërsa lojtari më i kërkuar i “dardanëve” në këtë afat kalimtar padashim se është Vedat Muriqi, i cili këtë sezoni shënuar 13 gola dhe ka asistuar tetë herë në 20 ndeshje. Fenerbahçe ka refuzuar ofertën e Burnleyt dhe Frankfurtit për Muriqin, por gazeta turke “Yeni Safak” raporton se shumë shpejt ofertë për reprezentuesin e Kosovës do të bëjë Manchester Unitedi. “Djatjtë e Kuq” kanë probleme në fazën e sulmit pas lëndimit të Marcus Rashford, prandaj janë gati të shpenzojnë 20 milionë funte përfaktorët e Lirisë së Prizrenit.

SHKURT

Gjeraj largohet nga Besa, rikthehet te Liria

Mbrojtësi me përvojë të madhe në futbollin e Kosovës, Robert Gjeraj, është larguar nga skuadra e Besës së Pejës dhe është rikthyer në Lirinë e Prizrenit. Lajmin e ka konfirmuar vetë futbollisti nëpërmjet një postimi në profilin e vet në “Facebook”. “Që nga sot jam pjesë e KF Liria. Falënderoj KF Besa që ma ka dhënë mundësinë të kaloj te Liria. Besën e falënderoj, po ashtu, që m'i hapi dyert në çastet më të vështira në karrierën time dhe prapë ma mundësoj që të riktheshem në vendlindje. Shpresoj që në fund të stinorit Besa dhe Liria të rikthehen në Superligë”, ka shkarkuar Gjeraj.

KF Drenica frikë nga tërmeti, rikthehet në Kosovë

Skuadra e Drenicës e ka përfunduar para kohe fazën përgatitore në Shqipëri, pasi të martën në mbrëmje është ndier një tjetër lëkundje e fortë e tërmetit në qytetin e Durrësit. Nga frika, ekipi i Drenicës e ka parë të udhës të kthehet sërisht në Kosovë dhe t'i vijojë përgatitjet deri në prag të fillimit të kampionatit. “Sot në mëngjes kemi mbërritur në Kosovë. Nuk kishte disponim që të qëndrojmë më shumë atje, sepse u krijua një panik”, ka thënë për “Olle”, Gani Sejdiu, trajner i Drenicës.

Suso kryen testet mjekësore te Sevilla

Jesus Suso tashmë mund të konsiderohet në të gjitha efektet një futbollist i Sevillas. Të mërkurën futbollisti i përfaqësueses spanjolle ka qenë në zyrat e klubit andaluzian për ta mbyllur marrëveshjen me Sevillan, ndërsa ka kryer edhe vizitat mjekësore në llogari të klubit nga “Ramon Sanchez Pizjuan”. 26-vjeçari është transferuar te Sevilla në formë huazimi për 18 muaj me të drejtë blerjeje nga ana e klubit andaluzian për një shifër që shkon te 20 milionë eurot.

Kosova, e fortë përfaktorët e Austrinë në futsall

Prishtinë, 29 janar - Përfaqësuesja e Kosovës në futsall e ka nisur në mënyrë të shkëlqyeshme rrëthim e parë kualifikues përfaktorët e Austrinës, i cili po mbahet në Gjeorgji, duke shënuar fitore në përfaktorët e Austrinës me rezultat 4-2. “Dardanët” e futsallit mbizotëruan në të gjitha

aspektet, derisa brenda tre minutave realizuan katër gola. Fillimisht realizoi Arbëri Dobroshi në minutën e 10 dhe më pas Dardan Topilla dhe Malush Qerimi dy herë. Pjesa e parë u mbylli me epërsinë e katër golave, por në pjesën e dytë austriakët i konsoliduan radhët dhe

arritën që të shënojnë dy gola nëpërmjet Dizdareviq (26') dhe Jatiq (35'), por pa arritur ta rrezikojnë fitoren e “dardanëve”. Ndeshjen e ardhshme në kuadër të Grupit F, Kosova do ta luajë sot (e enjte) kundër Gjermanisë, derisa në fund do të përballet me Gjeorgjinë.



Cardiffi ngre padi penale ndaj Nantesit

Cardiff, 29 janar - Megjithëse ka kaluar një vit nga aksidenti tragik që i mori jetën Emilian Sala, beteja ligjore mes Cardiffit dhe Nantes është ngritur në një tjetër nivel. Dy klubet akuzojnë njëri-tjetrin dhe kanë pretendimet e tyre financiare, pasi transferimi i

sulmuesit argjentinas nga Liga 1 në Premier Ligë u ndërprenë në mënyrën më fatkeqe të mundshme. Cardiffi dhe Nantes kishin arritur akordin përfutballistik në një operacion që afrohej me 30 milionë euro. Por, kur Emilian Sala po udhëtonte drejt klubit të

ri, avioni i tij u rrëzua në ngushticën e Le Mans, duke i shkaktuar vdekjen lojtarit dhe pilotit David Ibbotson. Pas përfballjes në shkallët e drejtësise sportive dhe me çështjen që pret vendimin e KAS, tashmë është ngritur edhe një padi penale.

Sipas "L'Equipe", Cardiff ka prezantuar një padi kundër një pale anonime për ta shqyrtuar përgjegjësinë e klubit të Nantes, presidentit dhe pronarit të tij në operacionin përftransferimin e Emilian Sala, që solli edhe vdekjen e tij. Padia bazohet mbi disa elemente të cilësuar "shqetësues" mbi organizimin e udhëtimit dhe avionit që u përfshi në aksidentin fatal.



SHGSK-ja: Gjithçka gati për ceremoninë e çmimit 'Ali Shala' dhe turneut 'Burim Hatipi'

PRISHTINË, 29 JANAR - Shoqata e Gazetarëve Sportivë të Kosovës ka mbajtur konferencën e fundit para ceremonisë për çmimin "Ali Shala" dhe turneut "Burim Hatipi", që mbahet më 31 janar në Prishtinë.

Kryetari i Shoqatës, Edmond Thaçi, nënkyetarët Jon Ajeti dhe Alba Merovci si dhe sekretari, Artan Muhaxhiri, kanë dhënë detajet për këto dy aktivitete në të cilat pritet të marrin pjesë mysfirë të shumtë nga vendi dhe jashtë. Numri një i gazetarëve sportivë, Edmond Thaçi, ka thënë se tashmë gjithçka është gati dhe se brenda 4 muajve sa është ky bord është arritur të përgatiten në mënyrën më të mirë të mundshme këto dy aktivitete. "Turneu 'Burim Hatipi' do të mbahet në Pallatin e Rinisë me fillim nga ora 10:00, ku do të marrin pjesë



8 skuadra. Aty do të ketë mysfirë nga Shqipëria, Maqedoni, Greqia e Kroacia", ka thënë Thaçi. Në anën tjetër për ceremoninë "Ali Shala" ka folur sekretari i SHGSK-së, Artan Muhaxhiri, i cili ka bërë me dije se ceremonia do të mbahet në Sallën e Kuqe në Prishtinë me fillim nga ora 17:00. "Në këtë ceremoni do të ndahen çmimet përfshirë shkrimin më të mirë, kronikën më të

mirë si dhe fotografinë më të mirë. Gjithashtu, do të jepet edhe çmimi 'Young Reporters' përfshirë gazetarin më të mirë të ri. Ky organizim do të jetë më special dhe më i mirë se herët e tjera. Fakti që e kemi zhvendosur këtë ceremoni në Sallën e Kuqe, atëherë kjo tregon se do të ketë shumë mysfirë dhe kjo normalisht se do të jetë një festë përfshirë gjithë gazetarët sportivë", ka thënë Muhaxhiri.

Fitojnë Philadelphia, Milwaukee dhe Toronto

TORONTO, 29 JANAR - Me përfashim të ndeshjes Lakers-Clippers, e shtyrë përfshirë shakat vdekjes së legjendës Kobe Bryant, të gjitha takimet e tjera janë luajtur në NBA. Skuadra e Milwaukee, kryesuese e renditjes në Konferencën e Lindjes, arriti fitore me rezultat 151-131 ndaj Washingtonit, në një ndeshje spektakolare. Ndeshje e mirë e Middletonit, që realizoi 51 pikë, ndërsa Bledsoe e mbylli me 36 pikë e 10 rebounde. Mirë u paraqit edhe Beal përfshirë, me 47 pikë, por që imbetën përfshirë statistikë. Skuadra e Philadelphias arriti fitore me rezultat 115-104 ndaj Golden States, sfidë që është dominuar nga vendësit. Në



këtë takim ylli i NBA-së, Joel Embiid, luajti me fanellën numër 24 në rast të Kobe Bryantit, duke realizuar edhe 24 pikë, më i miri në fushë. Fiton edhe ekipi kampion i Torontos, që e mundi me rezultat 130-114 Atlantan, sfidë ku

diferencën përfshirë kanadezët e bënë Siakam e Ibaka, me nga 24 pikë secili. Surprizë ishte humbja e Denverit, që u mund me rezultat 104-96 nga Memphis (Brooks 24 pikë), duke humbur disi kontakt me kreun në Perëndim.

REZULTATET

Charlotte - New York	97-92
Philadelphia - Golden State	115-104
Cleveland - New Orleans	111-125
Toronto - Atlanta	130-114
Memphis - Denver	104-96
Miami - Boston	101-109
Milwaukee - Washington	151-131
Dallas - Phoenix	104-133
Lakers - Clippers	(është shtyrë)

SHKURT

Identifikohet trupi i Bryantit

Aksidenti fatal me helikopter që i mori jetën Kobe Bryantit dhe vajzës së tij 13-vjeçare ka shtangur botën e sportit dhe jo vetëm. Ndërkohë policia e Los Anxhelosit vazhdon punën përfshirë identifikuar trupat e personave që ishin në bord, ndërsa tashmë është lajmëruar se është gjendur trupi i ish-basketbolistit dhe tre personave të tjera. Nga sa bëhet me dije, viktimat u identifikuani nga shenjat e gishtërinjve të tyre. Gjithashtu, raportohet nga mediat amerikane se disa pjesë të helikopterit ku udhëtonin viktimat janë dërguar përfshirë një ekspertizë më të detajuar, në një vend sekret. Kërkimet vazhdojnë ende, pasi nuk është gjetur trupi i vajzës 13-vjeçare të Bryantit.

Nadali eliminohet nga 'Australian Open'

Tenisti austriak Dominic Thiem ka mposhtur 3 me 1 në sete numrin një të botës, Rafael Nadalin, përfshirë nga "Australian Open". 6-7, 6-7, 6-4 dhe 6-7 ishin rezultatet e seteve në këtë meç të fazës çerekfinale. Në gjysmëfinale ai do të përfshirë me gjermanin Alexander Zverev. Gjysmëfinalja tjetër është ajo mes Roger Federerit dhe Novak Gjokoviqit.

Ibra, tifozëve të Milanit: Nuk jam larguar kurrë

Milani arriti një fitore të vështirë përfshirë Torinos, duke siguruar gjysmëfinalen e Kupës së Italisë, një sukses që është shoqëruar edhe me një mesazh nga Zlatan Ibrahimoviq: "Nuk jam larguar kurrë". Një mesazh i thjeshtë, por shumë domethënës i 'bomberit' suedezi. Një mesazh që tregon qartë se, pavarësisht qëndrimit përfshirë shtatë vjet larg 'San Siros', sulmuesi ka qenë gjithmonë pranë tifozëve dhe skuadrës. Që prej momentit kur është rikthyer Ibra, kuqezinjtë kanë ndryshuar jo pak, tri fitore radhazi në kampionat dhe një në Kupë, janë plot katër suksese radhazi që kanë rikthyer optimizmin në kampin e Milanit dhe sigurisht se ardhja e Ibrës ka dhënë menjëherë efektet e saj. Karizma e suedezeit, sigurisht edhe natyra e tij prej lideri, kanë rezultuar efikase.

Mari përfshirë Arsenalin

Arsenali ka zyrtarizuar Pablo Marin si lojtarin e vet pasi është arritur marrëveshja me Flamengon përfshirë shtatë vjet. Mari fluturoi përfshirë Angli së bashku me drejtorin teknik të Arsenalit, Edu, të shtunën përfshirë shtatë vjet larg 'San Siros', sulmuesi ka qenë gjithmonë pranë tifozëve dhe skuadrës. Që prej momentit kur është rikthyer Ibra, kuqezinjtë kanë ndryshuar jo pak, tri fitore radhazi në kampionat dhe një në Kupë, janë plot katër suksese radhazi që kanë rikthyer optimizmin në kampin e Milanit dhe sigurisht se ardhja e Ibrës ka dhënë menjëherë efektet e saj. Karizma e suedezeit, sigurisht edhe natyra e tij prej lideri, kanë rezultuar efikase.

Tottenhami prezanton Bergwijnin

Tottenham Hotspur ka përfunduar nënshkrimin e Steven Bergwijn nga PSV Eindhoven përfshirë një shifër të raportuar prej 25 milionë funtesh plus bonuset, kurse kontrata është deri në vitin 2025. Bergwijn mbërriti në veri të Londrës në fillim të javës përfshirë shtatë vjet larg 'San Siros'. 22-vjeçari i ka kaluar ato teste me sukses dhe tanë ka ardhur edhe zyrtarizimi nga Tottenhami. "Ne jemi të kënaqur ta njoftojmë nënshkrimin e Steven Bergwijn nga PSV Eindhoven. Steven ka nënshkruar një kontratë me Klubin që do të zgjasë deri më 2025", thuhet në njoftimin e "Spurs"-it.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

QKMF- „Dëshmoret e Lirisë“- Kaçanik
GCPM „Dëshmoret e Lirisë“- Kaçanik
MCFM „Dëshmoret e Lirisë“- Kaçanik

Nr.34/2020
Datë: 28.01.2020

Në bazë të nenit 8 të Ligj të Punës nr.03/L-212, Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave për themelirin e marrëdhënjes së punës në sektorin public, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare bënë :

SHPALLJEN E REKRUTIMIT

PËR: SHOFER -2 POZITA-
TEKNIK-E LABORANT MJEKËSOR- 1 POZITË
TEKNIK-E FARMACIE- 1 POZITË

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE
TITULLI I VENDIT TË PUNËS: Shofër- 2 (2 pozita)

Vendi i punës: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
Koeficienti: H-314/1
Numri i referencës së vendit të punës: 34/2020
Detyrat dhe përgjegjësitë:
Punon dhe drejton automjetet, të cilat i përdorë për kryerjen e besuar të detyrës së shoferit si autoambulanca, si dhe të gjitha automjetet tjera me të cilat disponon shëndetësia primare. Kujdeset përmirëmbajtien e tyre, në mënyrë që të jenë në gjendje të rregullt për intervenim dhe shfrytëzim. I përgjigjet shefit të shërbimit teknik, koordinon punën me shefin dhe me kolegët, si dhe kryen punë të tjera në kuadër të shërbimit.
Procedurat e konkurrimit: Procedura e konkurrimit është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm, si dhe ekzistues.
